

Dr. Avzi Mustafa • Xhevrije Mustafa

**GJUNË  
SHQIPE  
PËR  
KLASËN  
IV**



**TË ARSIMIT FILLOR  
NËNTËVJEÇAR**

Shkup, 2014

**Botues:** MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË  
Rr. Mito Haxhi-Vasilev Jasmi p.n.  
Shkup

**Recensues:** Hasan Hoda - kryetar  
Beie Ajrullau – anëtare  
Gëzime Shehu – anëtare

Me Vendim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 10-1633/2 të datës 19.06 2009, lejo-  
het përdorimi i këtij libri.

# PËR TË GJITHË FËMIJËT E BOTËS

Të gjithë fëmijët e botës - të bardhë dhe të zinj, të varfër dhe të pasur, vajza dhe djem - kanë të drejtë të barabartë në dashuri, mirëkuptim dhe ushqim; ata kanë të drejtë të jetojnë me nënën dhe babanë, të drejtë të shoqërohen dhe të dashurohen.

\* \* \*

Të mëdhenjtë janë të detyruar t'i mbrojnë dhe t'u mundësojnë fëmijëve të rriten në kushte të lirisë dhe dinjitetit. Ata nuk guxojnë të jenë të pakujdesshëm dhe të këqij.

\* \* \*

Të gjithë fëmijët e botës kanë të drejtë të shkollohen dhe t'i zhvillojnë aftësitë e tyre.

\* \* \*

Të gjithë fëmijët e botës kanë të drejtë në lojë, gëzime dhe këngë.

\* \* \*

Të gjithë fëmijët e botës kanë të drejtë të jenë të gëzuar.

**Nga Deklarata e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve**

## Bisede për motivim

Pasi mblidhen nxënësit në oborrin e shkollës, mësuesi ose mësuesja i fut në klasë dy nga dy në rresht. Pastaj u uron një vit të mbarë dhe e fillon bisedën me nxënësit duke i pyet si i kanë kaluar pushimet verore.



## PUSHIMET VERORE MBARUAN

Pushimet e verës mbaruan. Shtatori trokiti përsëri në portën tonë. Shkolla hapi dyert e saj, e zbukuroar si për festat e mëdha. Ajo na fton të ulemi përsëri në banka, të mësojmë gjëra të reja, të lozim, të zëmë shokë e miq të rinj. Dhe ja, nga katër anët vërshojnë drejt saj nxënës e nxënëse, me çantat në sup ose në dorë, plot me libra, disa mbajnë edhe tufa lulesh.

Mësueset dhe mësuesit kanë shkuar në shkollë më herët. Ata presin fëmijët shkollarë me fjalët e shqiptuara me aq ëmbëlsi:

- Mirë se erdhët, nxënës të dashur! Mirë se erdhët! Dhe nxënësit, si zogjtë e dallëndysheve,

i rrethojnë. Sytë e fëmijëve shkëlqejnë nga gëzimi. Ata u dhurojnë mësueseve të dashura buqeta me lule, përqafile. Kudo në oborrin e zhurmshëm të shkollës dëgjohen zërat:

- Gëzuar, mësuese!
- Gëzuar, nxënës të dashur! Gëzuar fillimin e vitit të ri mësimor!

Të lodhur, të pastër, plot gjallëri, nxënësit u ngjajnë luleve më të bukura të stinës. Oborri i shkollës i ngjan një kopshti të bleruar ku cicërojnë qindra zogj këngëtarë. Një shtatori është festa e tyre.

Ja, grumbuj, grumbuj ata u mblodhën përsëri. Ja Besa, Dritani, Dea e Shega duke biseduar njëra me tjetrën. Ja edhe Drita gazmore si gjithnjë, duke u përshëndetur me zërin e saj kumbues dhe me fjalët që i zgjedh aq bukur. Shikoni, shikoni Gëzimin! E ka çantën plot, si gjithnjë. Me siguri ka prurë libra e tregime. Ai lexon më shumë nga të gjithë të tjerët. Pastaj dy motrat, Ana me Norën. Po Bledari me Shqipen ku janë? Ja po vijnë.

-Urra! Edhe një vit bashkë  
Prapë zëra, prapë thirrje, pyetje përgjigje.

Befas të gjithë kthejnë kokën nga hyrja e shkollës. Një tingëllim i këndshëm dëgjo-  
het. Është tingëllimi i ziles së parë të vitit të ri mësimor.

Triiiiing!

Triiiiing!

Me tingujt e saj të gjatë ajo njofton:

“Viti i ri mësimor filloi.

Gëzuar festën, nxënës të dashur! Dalshi faqebardhë!

### T’i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

- trokiti përsëri - këtu erdhi prapë, u kthye
- vit shkollor - vit që fillon me ditën e hapje së shkollës dhe mbaron kur ajo mbyllet.
- Mirë se erdhët!  
Gëzuar vitin e ri mësimor!  
Dalshi faqebardhë!
- Urra! - thirrje gëzimi

### Bisedim

- Ritregojeni përmbajtjen sipas këtyre pikave të planit:
  1. Shtatori. Shkolla i pret krahëhapur nxënësit e saj
  2. Në oborr të shkollës - takime të përzemërta dhe gjithë mall.
  3. Zilja e parë. Urime për fillimin e vitit të ri mësimor.

### Të lexojmë bukur

- Lexoni katër fjalitë e para me zë të zakonshëm. Kujdes shenjat!
- Lexoni urimet dhe thirrjet. Shqiptoni ato me tonin e duhur.  
Vini re ndryshimin e tonit në krahasim me katër fjalitë e para.

### Detyra

- Ç’urime të tjera mund të përdorni me rastin e fillimit të vitit të ri mësimor? Shkruani ato.
- Beni një hartim të shkurtër me temë: “Dita e parë e vitit të ri mësimor”.

### Fjalë e urtë

*Punë, punë nat’e ditë,  
Që të shohim pakëz dritë.*

Naim Frashëri

### Bisede për motivim

Të nderuar arsimtarë/re, poeti në këtë vjershë para jush dhe para nxënësve tuaj e shtron një kërkesë: “Të mësojmë si të mësojmë”. Detyra juaj, por edhe unë ju kisha, lutur, që është të mos e harroni edhe detyrën edukative të punës suaj. Për këtë po e përmend edhe thënien e një njeriu të urtë cili thotë: “Njeriut të paedukuar truri i shërben si vjedhësit qiriri në kohën kur vjedh!”.

Mendoni dhe bisedoni me nxënësit mbi sjelljet e tyre në shtëpi, në rrugë dhe në shkollë. Si duhet të edukohet njeriu në jetë?



## RRUGA E JETËS

Pse shkojmë në shkollë?  
Që të mësojmë...  
Çfarë të mësojmë?!  
Të mësojmë si të mësojmë,  
të mësojmë si të nderojmë,  
të mësojmë si të lodrojmë  
të mësojmë si të përshëndesim,  
të mësojmë të ëndërrojmë,  
mund të mësojmë  
si të këndojmë,  
mund të mësojmë  
si të ndihmojmë,  
Të mësojmë e të mësojmë...  
Dituria nuk ka kufi  
është një rrugë mjaft e gjatë  
Për tu bërë njeriu NJERI

*Fejzi Bojku*

### T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

- Dituria nuk ka kufi - Dituria nuk ka skaj
- Është një rrugë shumë e gjatë - njeriu mëson gjatë gjithë jetës
- Për t'u bërë njeriu Njeri - Për qenë njeriu human

## Bisedim

- Pse fëmijët shkojnë në shkollë?
- Çfarë duhet të mësojmë në shkollë?
- Ç'kupton ti me fjalët: “Të mësojmë si të mësojmë”? Si mëson ti?
- Pse vjershëtari thotë se “Dituria nuk ka fund”?
- Cila është ajo rrugë që ju duhet ta kaloni për t'u përgatit në jetë?

## Plan për punë grupe

Ndani nxënësit në disa grupe:

- Grupi i parë le të bisedojë mbi atë që di mbi nderimin (në familje, në shkollë dhe shoqëri).
- Grupi i dytë le të bisedojë mbi lojërat (në familje, në rrethin ku jeton dhe në shkollë).
- Grupi i tretë le të bisedojë për ëndrrat e tyre (dëshirat e tyre, çka do të bëhem kur do të rritem?)
- Grupi i katërt le të bisedojë për ndihmën (si ndihmohet familja, pleqtë, shkolla, shoku, shoqja etj).

## Të lexojmë bukur

- Lexoni vargjet ku tregohet se çfarë të mësojmë.
- Mësojeni vjershën përmendsh!

## Detyrë

- Shkruani në fletore si e kaloni ju një ditë!

## Bisedë motivuese

Bisedoni për ëndrrat që i keni parë.

# ËNDRRA E DËRRASËS SË ZEZË

Dërrasa e zezë kishte rënë në mendime: “Nuk durohet më. Jam lodhur duke parë gjithnjë fëmijët të trembur, fëmijë që qajnë, që më shikojnë, thua se unë jam shtrigë që sjell fatkeqësi. Do të iki që këtej një ditë.”

Kështu, një ditë të bukur, më saktë një natë bukur, ia mbathi. Doli nga shkolla dhe toktok u nis për kurbet. Fshirësja u rrokullis dhe e ndoqi pas duke qarë:

-Zonja dërrasë e zezë, po vij edhe unë me ty.

Shkuan së bashku. Fshirësja fshinte retë e qiellit, që nata të behej më e qartë, fshinte semaforët e kuq, që dërrasa e zezë të kapërcente rrugën, fshinte gurët e rrugëve të fshatit, fshinte malet që ishin tepër të larta.

Një natë, fshiu edhe tre banditë, që donin ta vidhnin të shkretën dërrasë të zezë, për të bërë mbi të llogaritë e plaçkave që kishin grabitur.

Ec e ec e ec. Një natë të bukur dërrasa e zezë ndaloi.

- Fshirëse, - i tha jam shumë e lodhur...Kam nevojë të fle.

Fshirësja fshiu shkurret, manaferrat dhe gurët që gjendeshin përreth, që dërrasa e zezë të shtrihej e qetë mbi barin e pastruar, nën kuroren e një peme.

-Zonja dërrasë e zezë, - i tha fshirësja, - je shtrirë nën gështenjë. Ka rrezik që të bjerë ndonjë boçe në faqe e të të çjerrë, të të dëmtojë. Unë po e fshij edhe këtë pemë.

Por dërrasën e zezë e kishte zënë gjumi dhe po shikonte një ëndërr. Ëndërronte sikur ishte në mes të një livadhi, në këmbë, e rrethuar nga një tufë fëmijësh. Dhe fëmijët ishin nxënësit e shkollës së saj. Ata, të gëzuar, shkruanin me shkumësa me ngjyra: vjersha, fjalë e fjali, numra, vizatonin etj. Dërrasa e zezë e ndiente veten të lumtur. Nga larg u ndie zëri i fshirësës:

-Zonja dërrasë e zezë, zgjohu, se ka zbardhur dita.

-Jo, jo, nuk dua të zgjohem, iu përgjigj dërrasa e zezë,- Nuk do të zgjohem derisa që po shikoj, të bëhet e vërtetë.

I. Borsetto



## Fjalë dhe shprehje

u nis për kurbet  
semafor

- la vendin e vet, shkoi në një vend të huaj
- mjet me drita e ngjyra të ndryshme që e rregullon komunikacionin rrugor

banditë  
u ndie

- njerëz që grabitin sende
- u dëgjua lehtë

## Bisedim

- Lexojeni pjesën që tregon për shqetësimin e dërrasës së zezë!
- Gjeni dhe lexoni fjalitë ku tregohet se ç'punë bënte fshirësja për dërrasën e zezë.
- Lexoni përgjigjen e fundit të dërrasës së zezë.
- Lexoni pjesën sipas roleve (shkrimtari, dërrasa e zezë dhe fshirësja)

## Ta kuptojmë përmbajtjen

Ç'ndodhi një ditë me dërrasën e zezë?

Ç'punë bënte fshirësja për dërrasën e zezë?

Përse dërrasa e zezë nuk donte të zgjohej?

Cila ishte dëshira e saj?

Ritregojeni përrallën me fjalët tuaja

## Punë e pavarur

- Përgjigjuni me shkrim pyetjeve:  
A duhet ta ndihmonte fshirësja dërrasën? Përse?  
Çfarë pa në ëndërr dërrasa e zezë?

## Bisedë për motivim

Bisedoni me nxënësit mbi makinën që kryen veprime shumë të ndërlikuara.

### SA E GËZUAR JAM!



Nëna dhe babai e donin shumë Mrikën. Bënin çmos t'ia plotësonin çdo dëshirë. Ëndërronin t'ia blinin një kompjuter. Kursenin vazhdimisht, por nuk i tregonin së bijës. Dhe ia blenë kompjuterin pa e përmendur fare më parë. Mrika u gëzua shumë. Ajo e thirri menjëherë njëren nga shoqet e saj, që t'ia kumtonte lajmin e gëzueshëm.

Mrika: - Alo!

Drilona: - Alo!

Mrika: - Drilonë, si je ?

Drilona: - Mirë jam, Mrikë, mirë. E ti si je?

Mrika: - Unë jam shumë mirë. Madje jam shumë e gëzuar...

Drilona: - Ke ndonjë shkak të veçantë?

Mrika: - Posi. Nëna e babai më kanë plotësuar dëshirën e kamotshme..

Drilona: - Cilën dëshirë, moj?

Mrika: - Dëshirën për të më blerë kompjuter.

Drilona: - Ta kanë blerë?

Mrika: - Po. Sapo e vendosëm mbi tavolinë.

Drilona: - Urime, Mrikë! E gëzofsh!

Mrika: - Të falem nderit, Drilonë! E di që edhe ti je gëzuar, sepse mbetesh prapa nga shoqet dhe shokët e klasës. Nuk kisha si ta ushtroja punën me kompjuter. Do të vish ta shohësh?

Drilona - Posi, do të vij menjëherë. Mezi po pres ta shoh. Do të ushtrojmë së bashku. Besoj se për disa ditë ti do të mësosh mjaft. Nëse dëshiron, të sjell edhe ndonjë libër. Ti e di, im atë blen vazhdimisht libra për kompjuter.

Pas disa minutash Drilona hyri në shtëpi të Mrikës. Dy shoqet u përqafuan. Edhe në sy të Drilonës shihej gëzimi. U ul menjëherë pranë kompjuterit.

Nëna dhe babai i shikonin Mrikën dhe Drilonën pranë kompjuterit. U bëhej zemra mal kur e shihnin bijën e tyre të gëzuar.

### Bisedim

- Tregoni në sa tërësi logjike mund ta ndani këtë pjesë leximi?
- Tregoni se në cilën pjesë të tregimit flitet për diçka që është kryer.
- Tregoni në cilën pjesë flitet për diçka që ka ndodhur.

### Plan për punë grupe

Ndajeni klasën në tre grupe dhe kërkonin nga çdo grup që t'i nxjerrin foljet:

- grupi i parë foljet në kohën e tashme.
- grupi i dytë foljet në kohën e shkuar.
- grupi i tretë foljet në kohën e ardhshme.

### Detyrë

Zgjedhoni nëpër veta nga një folje të secilës kohë.

### Mbajeni mend

Tani është koha e kompjuterit. Pa ndihmën e tij nuk mund të merret me mend të bëhet asnjë punë. Për të mësuar të punosh me kompjuter duhet të ndjekësh edhe ndonjë kurs. Prandaj, nëse në vendlindjen ose shkollën tuaj hapen kurse për të mësuar përdorimin e kompjuterit, shfrytëzoheni rastin. Ai i cili nuk di të përdor kompjuter do të konsiderohet si analfabet.

### GJËEGJËZË

*Libra të tërë në një fletë, po shkronjat s'mund t'i lexosh vetë.  
Disku i kompjuterit*

## Bisedë për motivim

Bisedë mbi librat e lexuara apo lekturat e kl. III.

### LIBRAT RRINË RADHË-RADHË

Librat rrinë radhë-radhë,  
presin dorën qi t'i marrë.

Presin dorën t'i shfletojë;  
presin syrin t'i lexojë.

Sa përralla rrinë aty;  
eja t'i këndojmë të dy.

Sa figura, sa tregime,  
duan të hyjnë në botën time.

Librat rrinë krah për krah;  
cili vallë radhën e ka.

Thotë i pari: merrmë mua,  
siç me do edhe unë të dua:

Flet i dyti poshtë nën xham:  
po unë radhën kur e kam?

Librat rrinë radhë-radhë,  
Presin dorën që t'i marrë.



*Xhevair Spahiu*

### T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

rrinë radhë  
në botën time  
rrinë krah për krah  
siç më do edhe unë i dua

- radhë - rrinë pranë e pranë njeri-tjetrit
- në kujtesën time, në shpirtin tim
- rrinë pranë e pranë njeri tjetrit
- duan njeri-tjetrin

### Bisedim

- Ku gjenden librat?
- Çfarë presin ato?

- Çfarë përmbajnë librat në faqet e tyre?
- Kë ftojnë ato?
- Pse duhet të lexojmë libra?

### Ta kuptojmë përmbajtjen

Së pari formuloni tri apo katër pika plani dhe pastaj ritregojeni përmbajtjen e vargjeve që e lexuat.

Sa libra i keni lexuar? Cilët?

### Të lexojmë bukur

Lexoni strofat dyrrokëshe një nga një. Siç e shikoni, ato mbarojnë me pikë ose pikëpyetje. Kujdes theksin e tyre!

### Detyrë

- Mësojeni vjershën përmendsh. Recitoheni bukur atë!
- Beni një hartim të shkurtër me 4-5 fjali. Titullojeni “Libri” ose me një titull tjetër. Në fund kontrollojeni a i keni zbatuar drejt shenjat e pikësimit
- Shkruani titujt e librave që i keni lexuar!

### Fjalë e urtë

Libri është arma e të mençurit

## Bisedë për motivim

Detyrat e shtëpisë gjithsesi duhen të kryhen, por edhe të kontrollohen nga mësuesja.



## DETYRAT E SHTËPISË

Mësuesja u çua nga karrigia dhe tha:

-Tani do të shikojmë si i keni bërë detyrat e shtëpisë. A ka ndonjëri që nuk i ka ditur t'i zgjidhë detyrat? Le ta çojnë dorën ata që nuk i kanë bërë detyrat e shtëpisë!

U lajmëruan tre nxënës dhe një nxënëse. Ata kishin qenë të sëmurë. Mësuesja për ata nuk u hidhërua, por filloi që t'i shikojë nxënësit tjerë.

Erdhi te Jehoni. Shoku i bankës së Jehonit po i tregoi detyrat, kurse Jehoni nuk e kishte fletoren.

Jehon, ku e ke fletoren? - pyeti mësuesja. -Si duket ti nuk i ke bërë detyrat?

-Po, mësuese.

-Ku e ke fletoren?

-Unë e kam... unë e kam harruar.. në shtëpi.

Të gjithë nxënësit u kthyen me kokë nga Jehoni dhe filluan të qeshin. "Ne e dimë këtë arsytim! E kemi të njohur!" - thanë nxënësit duke buzëqeshur.

Jehoni u skuq dhe u turpërua:

-Pasha besën! - tha.

-Mirë, Jehon! -tha mësuesja. - Unë të besoj.

Jehoni në pushim me të shpejtë shkoi në shtëpi dhe e mori fletoren. U vonua disa minuta. Trokiti në derë dhe në dorë mbante fletoren.

-Urdhëroni mësuese! -tha ai. -E solla fletoren e detyrave!  
Pastaj shkoi në vend dhe u ul.  
I shikoi të gjithë me rend, por shokët dhe shoqet disi i iknin shikimit të tij.

V.S.

### T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

T'i zgjidhë detyrat - t'i kryejë detyrat

### Bisedim

- Gjeje në tregim vendin ku Jehoni u frikësua.
- Pse nxënësit i kthyen kokat kah Jehoni?
- Si reagueshan shokët dhe shoqet e klasës?
- Pse shkoi Jehoni në shtëpi?
- Si do të ndihej Jehoni nëse nuk e mbante besën?
- Ç'mendoni për sjelljen e shokëve të Jehonit?

### Ta mësojmë gjuhën tonë

Zakonisht pyesim kush nuk i ka bërë detyrat? Jehon ku e ke fletoren? Ose pyesim: S'bënë..?, Me kë...?, Sa është..., Ku gjendet...? Çfarë...?

Fjalitë me të cilat kërkojmë sqarim, me të cilat diçka pyesim quhen fjali pyetëse. Ato ku shprehim dëshirë e lutje quhen fjali dëshirore.

Në fund të këtyre fjalive cila shenjë qëndron. Në fund të fjalisë pyetëse qëndron shenja (?), kurse në fund të fjalisë dëshirore shenja(!)

## Bisedë për motivim Bisedoni mbi veshjen e fëmijëve

### STINËT

Me të shtatë ngjyrat,  
mbi letrën e bardhë,  
vizatoj natyrën,  
si piktor i rrallë.

Fushën gjelbëroj,  
dhe çel luleshqerrën,  
kështu në mes tonë.  
unë sjell pranverën!

Gjithë kalamajtë,  
plazheve i mbledh,  
zverdh grurin e artë,  
dhe verën sjell...

Rrushin pjek në vreshta,  
zogjtë larg i shpie,  
dhe pa pritur vjeshta,  
për mbi letër bie.

Erën e vë të fryjë,  
edhe retë të ikin,  
ujin bëj të ngrijë,  
dhe kamë sjell... dimrin.

### Fjalët dhe shprehjet

gjelbëroj           • këtu: ngjyros me ngjyrë të gjelbër  
luleshqerrën      • luledelen  
vreshta            • tokë e mbjellë me hardhi

### Bisedim

- Çfarë bisedon vogëlushi?
- Cilat janë stinët e vitit?



## Punë e pavarur

- Plotësoni emrat e muajve dhe stinëve që mungojnë

Muajt e vitit	figurat	stinët e vitit
janar		
	maj	pranvera
	gusht	shtator
tetor		dhjetor

## Detyrë

Shkruani në fletore vargjet për stinë të cilat ju pëlqejnë më shumë.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit mbi disa mjete teknike që i posedojnë ata në



## LIBRI, RADIOJA DHE TELEVIZORI

Anidi e la librin, pranë televizionit dhe doli të luante. Radioja që ishte aty pranë zuri ta ngacmonte.

-Habitem ç' të duan njerëzit ty kur zërin tim mund ta dëgjojnë kudo?-i tha ajo,-Ti tashmë je vjetruar. Pse të lodhen njerëzit ,mbi shkronjat e tua të imëta?

-Edhe ty të shkoi koha,- ndërhyri televizori.- Unë jam fjala e fundit e teknikës. Mrekullia vetë! Ëndrra mijëra vjeçare e njerëzimit. Krejt botën ia sjell në shtëpi çdo njeriu.

-Mos u krekosni kaq shumë,- u tha libri i qetë.- Së pari, kini një çikë nderim për më të vjetërit. Pastaj kujtoheni nga keni dalë. Pa dijen që kam bartur unë ndër shekuj, ju nuk do të zbuloheshit kurrë. Dhe, në fund, mua më duan ende njerëzit, sepse jam i pazëvendësueshëm...

Sakaq i ati i Anidit e mori radion e vogël që ta kishte me vete gjatë shëtitjes së pasdites. E ëma e tij hapi televizorin të shikonte një film. Edhe Anidi u kthye të vazhdonte leximin e librit.

Kështu, secili mendonte se ishte më i rëndësishmi.

Pas darkës babai, nëna dhe Anidi i shtrinë librat e tyre mbi tryezë. Ata zunë të punonin në qetësi. Radioja dhe televizori i shikuan me zili librat e shtrirë mbi tryezë, të cilët as që ia kishin ngenë të vazhdonin bisedën. Ato, fundja nuk kishin dëshirë të mburreshin. Vlera e tyre ishte dëshmuar tash mijëra vjet dhe nuk ishte zvogëluar fare as pas zbulimit të radios dhe televizionit.

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

- |                     |  |
|---------------------|--|
| të shkoi koha       | • të kaloi koha, u plake                                 |
| mos u krekosni      | • mos u lavdëroni kot                                    |
| një çikë            | • një grimë, pak   |
| zili                | • smirë, lakmi   |
| nuk ia kishin ngenë | • pa njohuritë që kam dhënë unë, që kam transmetuar unë. |

## Ta kuptojmë përmbajtjen

- Kush e filloi i pari bisedën dhe ç'tha?
- Ç'thotë televizori?
- Po libri si përgjigjet?
- Ç'ndodhi pas darkës?

## Të lexojmë bukur

Lexojeni sipas roleve pjesën ku bisedojnë radioja, televizori dhe libri.

## Detyrë

Shkruani çfarë ju pëlqen më shumë: ta dëgjoni radion, t'i shikoni emisionet e televizorit apo të lexoni libra.

## Fjalë e urtë

*LIBRI ËSHTË BURIM DIJE*

## GJËEGJËZË

Rrimë ulur n'kanape,  
ai na qëndron për ballë:  
krejt botën e sjell te ne,  
ashtu si është - të gjallë.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit kur kthehen nga shkolla çka bëjnë? Bisedoni: kur i bëjnë detyrat?

# ÇANTA E ALBIONËS

Albiona u kthye nga shkolla dhe me të hyrë në derë, e flaku çantën. Çanta e gjorë rrëshqiti e u fsheh nën divan. Shpejt e shpejt hëngri drekë dhe doli të luajë. Pas pak ia behën mysafirë. E ëma e zënë me ta, harroi ta thërrasë Albionën, të cilën e solli në shtëpi terri bashkë me urinë. E lodhur nga loja, ajo menjëherë fjeti.

Të nesërmen u zgjua dhe shpejtoi për në shkollë. Por ç'e do. E kishte humbur çantën. Sillej e mbështillej, assesi nuk mund ta gjente. Thirri tëmen.

-Mami, ku e kam çantën?

-Atje ku e ke lenë dje!

Filluan ta kërkonin të dyjat. Por më kot. S'u shkon te mendja te vendi ku ajo ishte strukur. U çuan të gjithë: i vëllai, e motra e vogël. Gjyshja. Shtëpinë e kaploi një tollovi e çuditshme.

Duke rrëmuar nëpër lodrat e veta, i vëllai bërtiti:

-Ja çanta e Albiones!

Tashmë ora e parë e mësimit kishte mbaruar. Kur e hapi çantën, ajo pa se detyrat s'i kishte bërë. Si të shkonte në shkollë! U shkreh në vaj. E ëma ia kuptoi hallin dhe filloi ta qetësojë duke këshilluar.

Atë ditë Albiona nuk shkoi në shkollë. Mungoi pa arsye. Të nesërmen mësuesja e qortoi dhe para nxënësve tregoi se ç'i ka ndodhur asaj. Që atë ditë Albiona jo vetëm që s'e humbi çantën, por edhe detyrat kurrë nuk i la pa bërë. U bë nxënëse e dalluar e me sjellje shembullore, ishte për çdo lavdëratë.

*Avzi Mustafa*

## Fjalët dhe shprehjet

divan	• shtrat i ngushtë afër murit të dhomës
flak	• hedh tutje menjëherë; e gjuajti
uria	• dëshira dhe nevojë për të ngrënë
strukur	• fshehur
shkrehu	• filloi të qajë me dënësë

## Bisedim

- Për çka flitet në këtë tekst?
- Cili veprim i Albionës nuk të pëlqen?
- Ç'na mëson ky tregim?

## Ta ritregojmë përmbajtjen

- Veprimi i Albionës
- Kërkimi çantës
- Mungesa nga shkolla

## Detyrë

Beni një orë pune për secilën ditë!

Shkruani një hartim të shkurtër me temë: "Njëherë më ndodhi"!

## Bisedë për motivim

Bisedoni me nxënësit duke u treguar se çdo popull e ka folklorin e vet: përrallat, le-  
gjendat, vallet këngët e veta. Edhe folklori i popullit tonë ka shumë përralla, valle,  
këngë e shumë legjenda, si: legjenda e Mujit dhe e Halilit, legjenda për Skënderbeun,  
legjenda e motrës me nëntë vëllezër (Konstadini dhe Doruntina) etj.

## DASHURIA PER VENDIN



Na paska jetuar njëherë e  
një kohë një fshatar. Atij  
i paskan lindur shumë  
fëmijë. Të gjithë të  
shëndosh si molla në  
gem, si vesa mbi bar  
.Në skaj të arës së tij  
paska qenë mali. Meqë  
fëmijët iu rritën. Fshatarit i duhej më  
shumë tokë për të nxjerrë bukën e  
tyre. Para se të hapte malin e ta bën-  
te arë, iu desh ta digjte, shkoi e pyeti  
një plak të urtë: “O plak i dheut!-ia

nisi,-Më duhet të çel malin për kafshatën e fëmijëve, po para se ta çel. Më duhet ta djeg.

Në pyll ka shumë kafshë e shpendë. Kam frikë se i djeg zjarri. Më mëso çfarë të bëjë.  
O plaku i dheut, që je i njohur për mençuri e dituri në katër anët e vendit”.

Plaku i dheut ishte menduar gjatë e më në fund e kishte këshilluar burrin me shumë  
fëmijë: “Merr daullen dhe bjeri tri ditë e tri net pareshtur. Duke i rënë, thirr me zë të lartë:  
“Për kafshatën e gojës së fëmijëve të mi, duhet t’i vë zjarrin malit, që të mund ta çel më lehtë.  
O shpendë, o kafshë dhe o të gjithë ç’merrni frymë në mal, ikni posa ta shihni zjarrin dhe të  
shikoni tym”.

Tri ditë e tri net kishte jehuar e gjëmuar lugina nga daullja. Pas tri ditës, siç thotë leg-  
jenda, fshatari ia paska vënë zjarrin malit, që të mund ta çilte.

Një ditë, duke punuar pranë një shkëmbi, pa skeletet e një shqiponje dhe të zogjve të  
saj. E pyeti: “Aman, moj shqiponjë, kur unë i rashë daulles tri ditë e tri net, në gjumë të thellë  
qëllove apo ishe shurdhuar që nuk ike?”.

Thuhet se skeleti i shqiponjës i paska folur e paska thënë: “As isha në gjumë të thellë,  
as isha memece e shurdhe, por nuk desha ta lëshojë truallin tim. Këtu linda e këtu desha të  
vdes”.

*Legjendë*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

- Legjendë - gojëdhënë, diçka që nuk i ngjan të vërtetës, diçka e pabesueshme
- Trualli im - këtu: vendlindja dhe vendbanimi im
- molla në gem - të shëndosha
- si vesa mbi bar - të pastër e të bukur
- për kafshatën e gojës - për bukën e gojës
- plaku i dheut e pabesueshme - plaku i urtë e i mençur

## Bisedim

- Pse fshatarit i duhej të hapte tokë të re?
- Ç'e shtyu të shkojë të këshillohet me plakun e dheut?
- Ç'këshillë i dha ai?
- Si veproi fshatari? Ç'cilësi mund të përmendni për një njeri të këtillë?
- Ç'kuptim kanë fjalët: Këtu lindi e këtu desha të vdes”?
- Si mund të thuhet i njëjti mendim me fjalë të tjera?

## Plan për punë grupe

Ritregojeni përmbajtjen sipas këtij plani:

1. Fshatari
2. Plaku i dheut
3. Aksioni
4. Shqiponja nuk e braktisi folenë.

## Detyrë


Emërtoni ndryshe pikat e planit të mësipërm.

**FJALE E URTË POPULLORE**

***DUAJE ATDHEUN SISHQIPONJA FOLENË.***

## Bisedë për motivim

Bisedoni me nxënësit se çfarë lodrash luajnë në lagje, ose në oborr të shkollës



Vizatim: Kafshët dhe shpezët

## ZËRAT E NATYRËS

Shokët e shoqet e klasës së katërt vendosën të luanin një lojë ku të mermin pjesë të gjithë. Po çfarë loje: sportive, popullore apo mësimore? Secili propozoi një lloj loje. Vetëm Lisi nuk foli. Ai dëgjonte mendueshëm. Meqë nuk po binin dakord, iu drejtua atij:

-Po ti çfarë propozon?

Lisi ngriti duart lart. Në to mbante aq fishe sa nxënës kishte klasa.

-Këtu, -tha ai,-janë tridhjetë kartonë të vegjël me ilustrime kafshës, sendesh, shpendësh etj.. Secili prej jush brenda pesë minutave të shkruaj përbëri ilustrimit ç'zë lëshon kafsha, shpendi, ose sendi. Kështu ai do të provoj sa di.

Të gjithëve u pëlqeu kjo lodër. Lisi shpërndau kartonat. Pas pesë minutash i mblodhi. Ja përgjigjet e tyre:

Bilbili ligjëron.

Bleta zukat, gumëzhin.

Delja blegërin Gjarpri...

Macja mjaullin.

Gjeli....

Miza zhuzhet.

Lopa...

Mushkonja zhuzhet.

Pula kakaris.

Qeni...

Rosa benë mak-mak.



Ujku ulurin.  
Zogu cicëron.  
Njeriu flet, qesh, bërtet, këndon.

Lisi kishte edhe një tufë fishesh për sendet. Këta ia shpërndau grupit tjetër. Ja përgjigjet e tyre:

Kambana tingëllon.  
Era fishkëllen.  
Deti buçet, uturin.  
Burimi gurgullon.  
Bubullima oshtëtin.  
Ora tingëllon Dera kërcet.  
Pushka kërcet.  
Pylli oshtëtin Treni....  
Topi gjëmon.

### T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

biem dakord- mendojmë njëlloj

### Ushtrime për punë të pavarur

- Plotësoni shtyllat me + ose - sipas modelit më poshtë:

	Zogu	Burimi	Ujku	Njeriu	Treni	Lopa
Flet						
Blegëron						
Mjaullin						
Buçet						
Pëllet	-	-	-	-	-	+
Jehon						
Zhuzhet						
Fishkëllen						
Tingëllon						
Gurgullon						
Cicëron						

## Bisedë


Në klasë duhet të sjellësh disa lloje të fjalorëve. Sidomos fjalori shpjegues i gjuhës shqipe, ndonjë fjalor xhepi, fjalor dygjuhësor etj. Nga nxënësit mund të përmendim ndonjë fjalë dhe ajo të kërkohet në fjalor për ta parë kuptimin e fjalës. Fjalori është i renditur sipas alfabetit të gjuhës.

## ARKA E FJALËVE

Arka e fjalëve është fjalori. Fjalori është një libër me të cilin ne mundemi me u përgjigj, jo vetëm kur të na pyesin për një fjalë, por është një libër, që secilit njeri duhet ta ketë me vete si luftëtari armët e veta:

- Është një libër i cili duhet të lexohet pandërprerë, dhe duhet të mbahet me vete edhe kur të jesh në fushë, në mal, në qytet apo fshat.

- Me një fjalë ditën me diell a natën me dritë duhet të lexohet e ndër të gjitha duke lexuar fjalorin është argëtimi i parë për ne. Duke kënduar e duke e mësuar fjalorin nga pak përditë, ne mësojmë gjuhën tonë e gjuha na hijeshohet ashtu duke biseduar edhe duke e shkruar.



*Shtjefën Gjeçovi*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

arka-është vendi ku ruhen gjëra  
kënduar -ka kuptimin e leximit

## Bisedim

- Pse thuhet për fjalorin se secili njeri duhet ta ketë me vete si “luftëtari armët e veta”? dhe kudo?
- Fjalori është një libër që pandërprerë lexohet? Pse?
- Duke e lexuar fjalorin dhe duke shkruar ç'dobi ka gjuha?
- Ç'shërbime na sjellin fjalët në marrëdhëniet tona me mjedisin që na rrethon?

## Detyrë

1. Bisedoni apo shkruani si mund të pasurohet gjuha jonë.
2. Mermi ndonjë libër apo revistë për fëmijë dhe shkruani fjalë dhe pastaj kërkoni në fjalor shpjegimin e tyre.
3. Nga vendlindja juaj mblidhni fjalë dhe vendosni në këndin e gjallë të gjuhës.
4. Bisedoni pse disa fjalë nuk janë në fjalorin e gjuhës shqipe si p.sh: opshtinë, plloshtad, ulicë, rekë, duvar etj.

## Bisedë motivuese

Shikoni librin dhe bisedoni pse disa fletë janë shkruar në rreshta e disa në vargje?

# ZHAKU DHE MËSUESI

Zhaku, burrë i thjeshtë, që u bë i pasur me tregti, ka dëshirë të bëhet i ditur dhe i njerëzishëm, që të mundë të shoqërohet me zotërinj të mëdhenj. Duke paguar shumë të holla, mori një mësues dhe nisi të mësonte në pleqëri. Ai mezi dinte të shkruante, prandaj e luti mësuesi që t'i ndihmonte në hartimin e një letre.

Ja biseda e tyre:

Mësuesi: A doni të shkruani atë letër në vargje (poezi)?

Zhaku: Jo, j o! Në asnjë mënyrë në vargje.

Mësuesi: Doni, pra në rreshta (prozë)

Zhaku: Jo! S'dua as në rreshta e as në vargje.

Mësuesi: Por, ju lutem, duhet të zgjidhni medoemos njëren apo tjetren formë.

Zhaku: Pse?

Mësuesi: Sepse, zotëri, kemi vetëm dy forma, me të cilat njeriu i shpreh mendimet e veta: në prozë dhe në vargje.

Zhaku: Qysh qenka vetëm vargu dhe rreshti?

Mësuesi: Ta merr mendja, zotëri, çdo gjë që nuk është në rreshta është vargje, dhe çdo gjë që s'është në vargje është në rreshta.

Zhaku: Po ç'është atëherë ajo kur njerëzit flasin njeri me tjetrin?

Mësuesi: Prozë (rreshta).

Zhaku: Si? Kur them: "Noris, sillmi papuçet dhe jepma kësulën e natës", -është e thënë në rreshta.

Mësuesi: Po, zotëri.

Zhaku: O zotëri! Dyzet vjet që flas në prozë e kurrjë nuk di për të! Të faleminderit shumë, zotëri, që më mësuat këtë.

*Molieri*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

i njerëzishëm

• njeri human, njeri që donë të ndihmoj

## Ta kuptojmë përmbajtjen

- Cilat personazhe janë paraqitur në këtë tekst?
- Për çka e luti Zhaku mësuesin?
- Pse shkrimtari e vë në tallje Zhakun?

- Si i kuptoni fjalët e Zhakut dhe të mësuesit?

### Ta mësojmë gjuhën

## TEKSTI DHE FJALIA

Lexojeni edhe në herë këtë tekst:

Ja biseda e tyre:

Mësuesi: A doni të shkruani atë letër në vargje (poezi)?

Zhaku: Jo, jo! Në asnjë mënyrë në vargje.

Mësuesi: Doni, pra në rreshta (prozë)

Zhaku: Jo! S'dua as në rreshta e as në vargje.

Mësuesi: Por, ju lutem, duhet të zgjidhni medoemos njëren apo tjetrën formë.

Zhaku: Pse?

Mësuesi: Sepse, zotëri, kemi vetëm dy forma, me të cilat njeriu i shpreh mendimet e veta: në prozë dhe në vargje.

### Mbani mend

Çdo gjë që ke lexuar-vjershë, tregim, përrallë, fabul etj. - quhen tekst. Teksti mund të jetë i shkruar në prozë (tregim, përrallë, fabul ose në vargje-poezi vjersha).

TEKST

NË PROZË

(tekst prozaik)

NË POEZI

(tekst në vargje)

Vjershat janë krijuar nga fjalët të cilat vjershëtari i zgjedh me kujdes dhe i radhit në vargje. Shumë vargje formojnë strofën. Strofa është një tërësi-një fotografi ose më shumë fotografi të lidhura.

Tekst është përmbajta e shkruar me fjalë e fjali.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit mbi fjalën shqipe dhe fjalët e huaja që përdoren, mbi fjalët e ëmbla, fjalët e këqija etj.

## FJALET

Fjalët i ngjajnë rrobave tingëllore të sendeve. Sipas tyre i njohim ato, i veçojmë njërën prej tjetrës, siç mund të dallojmë një mësues nga një ushtarë. Për shembull, kur dëgjojmë fjalën shkollë, kur nuk mendojmë për mollën. Por ndodh që një send nganjëherë të ketë disa palë rroba, ashtu si ne njerëzit. Merreni një shoqe tuajën. Ju e thirrni me emrin e vet. Nëna e quan bijë, vëllai i vogël e thërret motër. Të tjerët e quajnë çupë, gocë, vajzë ose çikë. Ju e keni shoqe. Por ajo është edhe nxënëse. E kjo është e njëjta, apo jo?

Herë-herë fjalët na duken si njerëzit.

Lindin. Rriten. Jetojnë gjatë, gjatë. Dalëngadalë edhe ndryshojnë.

Herë bëhen të shkurtra, herë të gjata. Por vazhdimisht përtëriten. Kështu rrallë u bie të plaken, e shumë më rrallë të vdesin fare. Zakonisht vdesin ato që nuk enden prej goje në gojë, prej letre në letër.

### Fjalët janë si lulet

Ata gjinden kudo përreth nesh. Disa janë këtu. Disa janë atje. Disa i di unë. Disa i di nëna. Disa i di mësuesja. Disa i gjen në gazeta. Disa i dëgjon në radio. Disa i mëson nga televizori. Po më së shumti fjalë ka në libra.

### Fjalët janë si urat

Pa to çdo njeri do të mbetet i vetmuar.

Merreni me mend, çdo të bënim po të mos ishin fjalët? Si do t'ia shfaqim nënës dashurinë tonë. Të pamatur? Si do të loznim me shoku- shokun? Si do ta përshëndetnim mësuesen kur të shkonim në shkollë? Si do ta njihnim botën përreth? Si do t'i shkruanim vargjet e tyre më të bukura Naimi, Migjeni...? Si do të jepte kushtimin Skënderbeu.

### Fjalët janë si ilaçet

Kush ka fuqi më të madhe shëruese ose Fjala e ëmbël e nënës, se fjala e çiltër e shokut, se fjala nga zemra e mikut?

Askush

Prandaj t'i përdorim si ilaçe. Si? Të flasim vetëm fjalë të mira, që ato do të na shërbejnë si ura, që të na i mbushin zemrat me dashuri.

Atëherë edhe unë në fund po u them një fjalë të mirë: MIRUPAFSHIM

*Arif Demolli*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

rrobave tingëllore- sendeve që japin zë  
prej goje në goje- prej njeriut në njeriun kur me atë flasim  
prej letre në letër-kur me gjuhën shkruajmë mendimet tona  
shfaqim- shprehim  
kushtrimin-thirrjen  
çiltër-pastër

### Bisedim

- Ç'shërbime na sjellin fjalët në mjedisin që na rrethon?
- Pse autori i krahason ato me rrobat, lulet, urat, ilaçet?
- Ç'kuptoni me shprehjen “se fjala nga zemra e mikut”?

### Ta ritregojmë përmbajtjen

- Duke u mbështetur në nëntitujt ritregoni këtë pjesë.
- Jepni mendimin tuaj për rëndësinë që ka fjala, duke u mbështetur në ndonjë rast tuajin.

### Detyrë

1. Shkruani në fletoret tuaja fjalë urimi
2. Bisedoni me prindërit e juaj

## Zgjerim njohurish

Në kohën tonë gjuha përdoret në dy mënyra: me gojë dhe me shkrim. Ne flasim gjithë ditën, por shkruajmë kur kemi kërkesa. Asaj gjuhe që e flasim gjithë ditën i themi gjuhë e gjallë, kurse atë që e shkruajmë i themi gjuhë e shkruar.

## Fjalë e urtë

Gjuha e ka rrënjën në zemër.

## Ta mësojmë gjuhën

### Emrat konkretë dhe emrat abstraktë

#### Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit për emrat që tregojnë njerëz, shtazë dhe sende.

Detyrë: Lexojeni tekstin e mëposhtëm dhe vëreni me kujdes çfarë tregojnë fjalët e nënvizuara

### VENDOSMËRIA E GENTIT

Qëndrimi ishte nisur për stadium të qytetit për të shikuar ndeshjen e futbollit. Rrugës takoi shokun e shkollës Gentin.

- Gent, eja të shkojmë në ndeshjen e futbollit. Do të jetë lojë interesante.
- Jo, tha Genti, nuk kam mundësi. Ia kam dhënë besën djalit të hallës Malborit se do t'ia punoj sot një lodër për lojë. Për këtë Malbori do të ndiejë kënaqësi do të më përqafojë nga gëzimi. Të kujtohet, Qëndrim edhe ne kur jepnim fjalën e nderit, punët i kryenim më zemër. Pa vendosmëri nuk ka punë të mirë as sukses.

#### Shpjegim

Në tekstin e mësipërm kemi emra njerëzish (Qëndrimi, Genti, Malbor, shoku, djali), emra sendesh (stadiumi, rruga, lodra). Pra, kemi emra që mund t'i shohim dhe t'i prekim. Këta emra janë konkretë. Por, gjithashtu kemi edhe emra të tillë që nuk mund t'i shohim e as t'i prekim. Si p. sh.: mundësi, besë, kënaqësi, nderë, vendosmëri, sukses. Këto emra nuk tregojnë gjera që mund të preken, por vetëm merren me mend, prandaj quhen emra abstraktë.

#### Detyrë

- Shkruani nga pesë emra konkretë dhe pesë abstraktë.



### Fjalët dhe shprehjet

- shkreptima • vetëtima  
nxihen retë • errësohet qielli  
krijes' mjerë • bimë fatkeqe

### Të lexojmë bukur

- Lexojeni vjershën sipas roleve.
- Kini kujdes si flet secila pishë.

### Bisedim

- Cilat pisha bisedojnë?
- Ç' thotë pisha e shtrembër ?
- Si i përgjigjet pisha e drejtë?

### T'i zgjerojmë njohuritë

Me siguri e keni vënë re se fjalët pish' e gjat' dhe krijes' autori i shkruan pa [ë], do të thotë me apostrof [']. Ai vepron kështu për ta rregulluar numrin e rrokjeve, që vargjet të tingëllojnë bukur.

## DY PISHA

Një pish' e shtrembër në përrua  
I tha një pishë krahë-gjatë:  
-Sa keq, moj motër, më vjen mua,  
Që je e madhe dhe e lartë!  
-Po pse? E pyeti pish' e drejtë -Po ja, kur  
shkrep në qiell rrufe,  
Kur sipër malesh nxihen retë,  
Të djeg të parën ty mbi dhe,  
Se trupi yt i gjat' i gjatë  
Në sy të botës bie.  
-E kam nder- e gjata thotë-  
-Që shkreptima të më bjerë,  
-Po të mos fshihem nëpër botë  
Si ti krijes' e mjerë!

*Dritro Agolli*

### Mësoni

**Dritro Agolli (1931) është njëri nga poetët dhe prozatorët më të njohur bashkëkohorë shqiptarë.**



## Bisedë motivuese

Beni një vizitë përmendores së Skënderbeut në Shkup



## MIRË SE ERDHE NË SHKUP, SKËNDERBE!

Mirë se erdhe, Skënderbe!

Ti në Shkup, sa ishe gjallë, kalove vetëm një herë kur u nise për të shkuar në Krujë. Po hija e jote madhështore shtrihej kudo ku kishte shqiptarë. Shembulli yt na mbante gjallë ndër shekuj. Flamuri yt ishte gjithnjë në ballë...

Po liria, prapë nuk e gjeti dot rrugën deri te ne.

Ndërroreshin pushtuesit.

Se cili me i egër se tjetri.

Ti mbete gjithnjë në zemrat tona.

Ti ishe në këngët tona, në vjershat tona, në punëdoret tona të burrave e të grave..

Ardhja e jote në sheshin e Shkupit në zemrën e shqiptarisë a|| nuk është thjesht një ngritje përmendoreje. Ajo është simbol i lirisë sonë të ëndërruar me shekuj.

Jemi të lumtur që e pritëm këtë ditë!

*Përshtatje*

Ky tekst i drejtohet Skënderbeut me rastin e ardhjes së përmendores së tij në Shkup. I dëshirojmë mirëseardhje, sepse kjo përmendore u punua në Tiranë. Ardhja e saj qe një gëzim dhe një manifestim për të gjithë shqiptarët. Prandaj autori thotë: “Jemi të lumtur që e pritëm këtë ditë”

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

hija jote madhështore

gjithnjë në ballë

ti mbete gjithnjë në zemrat tona

• çdoherë përpara

• çdoherë mbete i dashur

## Bisedim

- Çka nxite shëmbëlltyra e Skënderbeut?
- Çka ndodhi te shqiptarët gjatë shekujve?
- Si mbeti në kujtesë Skënderbeu gjatë shekujve?
- Çka na flet përmendorja e Skënderbeut?

## Detyrë

Përkruaje si e ke përjetuar vizitën e përmendores së Skënderbeut ose të ndonjë heroi tjetër kombëtar.

Të mësojmë për gjuhën

## FJALIA DHE PJESËT E SAJ

Urimi i mirëseardhjes së përmendores së Skënderbeut në Shkup është bërë nëpërmjet disa fjalës. Me fjali behet marrëveshja më e zakonshme e midis njerëzve. Që kjo marrëveshje të jetë e suksesshme, fjalët duhet të jenë qarta, të formuara drejt, si kur flasim, si kur shkruajmë.

Fjalja është njësia më e vogël që shpreh një mendim ose një ndjenjë. Ndërtimi i saj mund të jetë shumë i thjeshtë, por edhe i ndërlikuar. Është i thjeshtë, kur fjala është e shkurtër, pra kur përbëhet prej pak fjalësh. Është e ndërlikuar, kur ka më shumë fjalë, madje kur përmbahet prej disa fjalive të thjeshta

FJALITE:

Anidi lexon.

Anidi lexon I librin.

Drita shkruan.

Drita shkruan I pa gabime.

Skënderbeu erdhi.

Skënderbeu erdhi I në Shkup.

Fjalitë dallojnë nga njëra-tjetra. Në rastin e parë përbëhen vetëm nga dy pjesë (gjymtyrë). Pjesa e parë (Anidi) quhet kryefjalë, kurse pjesa e dytë (lexon) quhet kallëzues.

Kryefjala e tregon atë që bën një veprim, kurse kallëzuesi tregon veprimin e kryefjalës. Kryefjala dhe kallëzuesi përdoren gjithnjë pranë njeri-tjetrit.

Kryefjala mund të jetë një emër

Dritoni shkon në shkollë.

ose një përemër

Unë luaj me top.

Kallëzues vetëm folja

Dritoni shkon në shkollë

### Detyrë

1. Nga teksti “Mirë se erdhe në Shkup Skënderbe!” i përshkruaj tri fjali me të cilat do të gjesh kryefjalën dhe kallëzuesin.
2. Shkruaj pesë fjali në të cilat kryefjalë do të jenë fjalët: Agimi, nëna, ai, ne dhe nxënësit, kurse kallëzues janë fjalët: lexon, shkruan, vizaton, luajmë dhe mësojmë.

## Bisedë për motivim

Lexoni tekste nga e kaluara historike për arsimin shqip. Njoftohuni me punën e madhe j të patriotëve shqiptarë për shkollën shqipe. Pse kremtohet 7 Marsi?

## RREZIKU NGA ABETARJA E PARË

Më kujtohet shpeshherë një ngjarje e frikshme që më ka ndodhur në kohën e Turqisë, kur isha nëntë vjeç.

Një ditë, duke kërkuar një arkë të vjetër të tim ati, gjeta një libër me fletë të kuqe përsipër dhe me shkronja, që nuk i dija t' i lexoja. Me atë libër në dorë u nisa të shkoj te sheshi i lagjes që është edhe tani qendra e lodrave për fëmijët e qytetit.

Duke ecur udhës papritur më kapi dhe shtrëngoi krahun një dorë e fuqishme.

Ktheve kokën menjëherë dhe pashë se më kishte zënë një xhandar i madhe i vrenjtur. Ai ma rrëmbeu librin me dorën tjetër, i hodhi një sy dhe duke vështruar me të egër, më pyeti se i kujt isha. U tremba aq tepër, sa m'u prenë gjunjët dhe u hutova, mirëpo xhandari më ngriti pezull në erë dhe më përplasi përdhe duke thirrur që t'i tregoja emrin e babait tim. Ia thash emrin dhe shkova në shtëpi, pa u menduar se ç'mund të ndodhte pas kësaj.

Nuk kishin shkuar mirë dy orë, kur pa pritur u dukën në krye të rrugës shumë xhandarë të armatosur me kryeplakun e lagjes përpara. Me të parë xhandarët turq, lajmërova babanë, u dhashë shpejt këmbëve dhe u fsheha në kopsht. Isha strukur në mes të një gjolle me presh dhe po mbaja vesh se ç'do të ngjante. Në këtë kohë pashë tim atë që doli në dritaren e anës së kopshtit dhe kapërceu jashtë me nxitim. U ngrita dhe desha t'i shkoj pranë. Ai më pa, më bëri me shenjë që të mos të flisja dhe iku përmes vreshtit, duke rënduar me trup të përkulur, që të mos e shihnin. Atëherë më hyri frika më tepër, u futa më thellë në gjolin e preshve dhe aty po rrija i tulatur duke qarë pa zë.

Pas një tollovie dhe një rrebeshi që ndodhi në shtëpinë tonë, unë kuptova se tërë ajo që erdhi ishte nga abetarja shqipe që ma zuri në dorë xhandari turk. Abetarja shqipe ishte e ndaluar.

*Kolë Koci*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

në kohën e Turqisë - kur Shqipëria ishte pjesë e Perandorisë Osmane

pezull- e ngriti në ajër

xhandar - polic

i vrenjtur - i mërrolur

u dhashë shpejt - me shpejtësi ika

strukur - fshehurazi

gjoll - pjesë e ngritur dhe pak e ndarë në një arë, për të mbjellë diçka më vete.

rrebesh - stuhi, kur bie shi ose erë shumë e fortë

m'u prenë gjunjët - m'u prenë këmbët, nuk mund të lëvizja

tulatur - i strukur diku për të mos rënë në sy

### Të lexojmë bukur

- Veçoni pjesën për të cilën tregohet për djalin që rrinte i fshehur në kopsht.
- Lexojeni heshtazi dhe pastaj me zë

### Bisedim

- Pse xhandari e ndaloi djalin? Çfarë i kërkoi atij?
- Çfarë ndodhi më pas? Ku iku babai?
- Në ç' kohë mund të ketë ngjarë kjo?
- Përse ishte ndalur këndimi dhe shkrimi në gjuhën shqipe?
- Kur filloi të mësohet lirisht gjuha shqipe në shkollë?

Ta ritregojmë pjesën duke u mbështetur në këto pika:

1. Gjetja e librit
2. Vajtja te sheshi i qytetit me libër në dorë
3. Rrëmbimi i librit nga xhandari
4. Masat që mori xhandarmëria
5. Fshehja dhe ikja e djalit dhe e babait

### Detyrë

- Shkruani nga një vjershë për shkollën, mësuesin/mësuesen.
- Si e festoni ju 7 Marsit - Ditën e Mësuesit në shkollën tuaj?

## Bisedë motivuese

Bisedoni në klasë me çka dallohen fëmijët shqiptarë nga fëmijët e kombeve të tjerë. Sigurisht jo me të quajtur dhe me të qeshur, por me.....

## UNË JAM SHQIPTAR

-Po çka je, mor djal, i mbarë?  
-Besa-besën jam shqiptar,  
Se Shqipëria m'tha një fjalë  
"Me ke nanë e të kam djalë."

Mos harro se je shqiptar,  
E ke zemrën plot me zjarr,  
Mos haro se të kam bir,  
T' ka rrit nëna zog të lirë!"

Veten time s'e koris,  
Se kështu e kam për fis,  
Besa-besën mos ta shes,  
Por, për vendin tim të vdes!

### Fjalë dhe shprehje

mbarë - i vyeshtëm  
besa - fjala e dhënë  
koris - turpëroj  
zog të lirë - ka kuptimin e lirisë, pa pranga  
plot me zjarr - plot me ashk, dashuri, vrull  
e kam për fis - e kam për traditë të moçme

### Bisedim

- Si u kuptua djali se çka është me kombësi?
- Si i kuptoni dy vargjet e strofës së parë  
"Se Shqipëria m'tha një fjalë  
Me ke nanë e të kam djalë"
- Cila është porosia e vjershëtarit?
- Me çka dallohet shqiptari?
- Cila është besa e tij?

### Detyrë


1. Mësojeni vjershën përmendsh dhe recitoheni me dashuri para prindërve!
2. Kërko ndihmë edhe nga mësuesja që vjershën ta recitosh edhe me gjeste!



# GJUHA JONË


1.

Gjuha jonë sa e mirë  
sa e ëmbël, sa e gjerë,  
sa e lehtë, sa e dliirë,  
sa e bukur, sa e vlerë!




2.

Porsi kanga e zogut t' verës,  
që vallzon në blerim t' prillit,  
porsi i ambli fllad i erës,  
që l'mon gjit' e drandofilit,  
porsi vala e bregut t'detit,  
porsi gjama e rrufes zhgjetare,  
porsi ushtima e një tërmeti,  
njashtu a gjuha e jonë shqiptare.



3.

Shqipja qysh u është dukur?  
Sa ëmbël, sa e bukur!



- T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet e dliirë
- e pastër
- e vlerë
- me vlerë, me rëndësi
- zogu i verës
- shpend që lajmëron ardhjen e verës
- rrfë zgjetare
- rrufe goaitëse
- a (dialektale)
- është
- shqipja
- gjuha shqipe

## Të lexojmë bukur

- Lexoni me kujdes vargjet që mjeshtrit e mëdhenj kanë shkruar për gjuhën amtare.
- Shqiptoni drejt dhe pa shtrembërime vargjet

## Bisedim

- Ç'cilësi të gjuhës sonë i vë në dukje Naim Frashëri?
- Me çfarë e krahason Gjergj Fishta bukurinë dhe forcën e gjuhës shqipe?
- Ç'cilësi të gjuhës shqipe vë në dukje Andon Zako Çajupi?

## Punë e pavarur

- Plotësoni fjalitë e mëposhtme:  
Naimi shkruan se gjuha shqipe është ë \_\_\_\_\_  
Fishta shkruan se gjuha shqipe është si \_\_\_\_\_
- Kopjoni në fletore vargjet që i mësuat përmendsh.
- Mos harroni porosinë në fund të vargjeve të autorit.
- Ç'ndieni kur i lexoni këto vjersha? Bisedoni me njeri-tjetrin.

## Detyrë

Mësoni vargjet e poetëve përmendsh!

## MËSONI

Naimi, Fishta, Çajupi janë poetë të shquar.  
Ata punuan për gjuhën shqipe. Për t'i nderuar, ne i quajtmë mjeshtrë të gjuhës shqipe.

## DIALEKTET DHE GJUHA STANDARDE

Lexoni edhe njëherë këto dy vargje

1.

**Gjuha jonë sa e mirë  
sa e ëmbël, sa e gjerë,  
sa e lehtë, sa e dli­rë,  
sa e bukur, sa e vlerë!**

2.

**Porsi kanga e zogut t'­verës,  
që vallzon në blerim t'­prillit,  
porsi i ambli fllad i erës,  
që l'mon gjit' e drandofilit,  
porsi vala e bregut t'­detit,  
porsi gjama e rrufes zhgjetare,  
porsi ushtima e një tërmeti,  
njashtu a gjuha e jonë shqiptare.**

Nga këto dy strofa në gjuhën e përdorur vërejmë re fjalët janë larguar nga gjuha letrare. Për shembull, në strofën e parë: vlerë, dëlirë dhe në strofën e dytë: kanga, ambli, gjama, njashtu, a etj., poetët i kanë thënë në dialekt. Konkretisht strofa e parë është thënë në dialektin e toskërishtes, kurse strofa e dytë në dialektin e gegërishtes. Pra gjuha shqipe është e përberë prej dy dialekteve dhe atë: nga dialekti i toskërishtes dhe nga dialekti i gegërishtes.

Për ta kuptuar më mirë gjuhën tonë, gjuhën shqipe duhet të flasim dhe të shkruajmë në gjuhën letrare.

### Detyrë

1. Lexoni një përrallë dhe shkruajeni në gjuhën letrare (standarde)!

## Bisedë për motivim

Bisedoni për njerëzit që jetojnë jashtë atdheut në vend të huaj. Bisedoni për kuptimin e kësaj fjale të urtë: “Guri i rëndë peshon në vend të vet”.

## KUJTOJ MËSUESIN

Pat ikur mësuesi im në Turqi,  
unë abetaren e lava me lot,  
Në zemër më hyri fytyra e tij  
dhe s'më hiqet as sot.

I vogël isha atëherë, pak dija,  
jeta më dukej lojë e dëfrim,  
po ngado që shkoja, kudo që vija  
shihja fytyrën e mësuesit tim.

Dëgjoja zërin e tij të dashur,  
kur binte zilja për mësim,  
dëgjoja zërin e tij të dridhur:  
“E di çështë mërgimi ti, Agim?”.

.....

Kaluan ditë, kaluan vjet,  
librin nga dora s'e lëshova  
në banka të shkollës edhe në jetë,  
punët e kësaj toke mësova.

.....

Sot, kur edhe vet me ditarë,  
dal përpara nxënësve të mi,  
e kujtoj mësuesin tim të parë,  
arratisur larg në Turqi

*Agim Vinca*



## Fjalë dhe shprehje

mërgim

Anadoll

punët e kësaj toke

- të jetuarit jashtë atdheut, në një vend të huaj
- zonë në Azinë e Vogël, ku kanë mërguar shumë shqiptarë
- gjëra të jetës së përditshme

## Lexoni bukur

Lexoni me kujdes dhe në fillim ngadalë. Vini re gati se çdo varg shpreh një mësim në vete, kurse çdo strofë i bashkon disa mendime. Lexoni një nga një strofat dhe pastaj gjithë vjershën. Recitoheni vjershën më 7 Mars, në Ditën e Mësuesit.

## Bisedim

- Pse Agimi e lagu me lot abetaren?
- Pse Agimi e kujton gjithnjë mësuesin?
- A dinte djaloshi kuptimin e fjalës mërgim?
- A e ka harruar ai mësuesin tani që është bërë vetë mësues?

## Ta ritregojmë përmbajtjen

- Përpiquni t'i plotësoni pikat e planit. Mund të filloni kështu:

1. Trishtimi i Agimit
2. Malli...
3. Me kalimin e viteve...
4. Sot...

## Detyrë

- Mësojeni përmendsh vjershën.

## Bisedë për motivim

Me nxënësit duhet të bisedohet për ta kuptuar se ç'është vendlindje, çfarë rëndësie ka vendlindja dhe pse është e bukur vendlindja?.

## TOKA IME, KËNGA IME!

E dua këtë tokë,  
Tokën time mëmë,  
Ku kam parë diellin,  
Ku kam parë hënën.

E dua këtë tokë,  
Me shkëmbinj e gurë,  
Ku të parët tanë,  
Shpalosën flamurë.

Ku po jetoj unë,  
Me nder e gëzim,  
Ajo ma gatuan,  
Zemrën shpirtin tim.

*Besim Shyti*

### Bisedim

- Me këto vargje të bukura vjershëtari na kallëzon se çka quhet vendlindje.
- Në strofën e dytë vjershëtari shtron pyetje. Pse e do vendin e vet? Përpiqu t'i përgjigjesh ti vjershëtarit, por vetëm me një fjali.



## GJINIA E EMRIT

### Lexoni tekstin

### NË KOPSHT

Mira shkoi në kopsht. Atje ishte teta Teuta, fqinja e saj e vogël. Sa u gëzua Teuta kur e pa mbesën Emirën! Si flutur, vrapoi drejt saj dhe i hodhi duart në qafe. Kur u kthye në shtëpi, Bora i qepi një fustan të bukur. Sa u gëzua vogëlushja!

Beni i vogël nuk ishte në shtëpi kishte shkuar te Zana. Atje me hallën dhe me xhaxhanë Dashmirin dëshironin të vizitonin gjyshin dhe gjyshen në fshatin e Kodrinës. Beni shumë gëzohet sepse atje te gjyshi ka shumë mollë e pjeshka të ëmbla.

Nga teksti i mësipërm janë dalluar emrat:

Mira, Teuta, Emira, flutur, Bora, shtëpi, Zana, halla. Xhaxhanë, gjyshi, gjyshja, Beni, Kodrina, molla, pjeshka.

Nga këto shembuj shohim se emrat na dalin me trajta të ndryshme. Ata kanë gjini dhe ndryshojnë sipas saj. Pra emrat kanë gjininë mashkullore dhe gjininë femërore

### SHPJEGIM:

Emrat dallohen edhe për nga gjinia. Emrat: Teuta, Emira, Bora, Zana, mbesa, gjyshja, halla, molla, Mira, flutura, pjeshka etj., janë emra të gjinisë femërore.

Emrat: xhaxhai, gjyshi, Beni, Dashmiri, fshati etj., janë emra të gjinisë mashkullore.

Emrat e mashkullore janë emra që në trajtën e shquar mbarojnë me -i dhe -1 kurse emrat e u, gjinisë femërore mbarojnë me -a (-ja)

Emrat e të dy gjinive e kanë numrin njëjës dhe numrin shumës. Emrat që emërtojnë vetëm një vetëm një send, një njeri, një kafshë janë në numrin njëjës, kurse emrat që emërtojnë dy e më tepër sende, njerëz e kafshë janë në numrin shumës. P.sh. *një laps, një libër, një lepur janë në numrin njëjës, kurse shumë lapsa, shumë lepuj (lepujt), shumë libra, shumë lapsa (lapsat)*

## Bisedë për motivim

Më 19 tetor të vitit 2003 është bërë Lumturimi i Nënës Terezë. Lexoni diçka nga biografia e Nënës Tereze.

## NËNA JONE TEREZE

Nënë Tereze, nënë e mirë  
Për të varfrit ke pas mëshirë.

Në të këqia e në të mira,  
dhe në çaste shumë të vështira.

Nënë Tereze, oj nënë bujare.  
Ti oj bijajonë shqiptare.

Kurrë s'të harrojmë oj nëna jonë.  
bamirëse e shekujve tonë.

*V Prekpalaj*

### Bisedim

- Kush është Nëna Tereze?
- Kujt i ka ndihmuar ajo?
- Çfarë kombësie është ajo?

### Detyrë

1. Tregoni disa shoqata humanitare që veprojnë në vendin tuaj.
2. Bëhuni anëtar i ndonjë shoqateje?
3. Shkruaj shkurt si u ndihmon ti shokëve dhe shoqeve në shkollë.



### Bisedë për motivim

Bisedoni me nxënësit a e kanë vizituar ndonjë pjesë teatrale. Ku është luajtur pjesa, kush e luante pjesën teatrale etj.

## NJË NDODHI NE RRUGE

### Luani-Luli-Agroni-Gjyshi

*(Luli dhe Luan kanë luajtur me baltë dhe janë bërë pis, Ecin rrugës. Në cep duket një gjysh me trastë në dorë)*

- LULI - Luan, shkojmë ta ndihmojmë atë plakun?  
LUAN - Vemi! (i shkojnë pranë gjyshit).  
TË DY - Gjysh, o gjysh!  
GJYSHI - (i dëgjon, ul trastën në tokë dhe i pyet). Për se më thirrët?  
LULI - Duam t'ju ndihmojmë. A ta marrim ne trastën tuaj?  
GJYSHI - (Ngre kokën, i shikon që të dy nga koka gjer te këmbët, pastaj merr trastën në dorë dhe u përgjigjet): Jo, vogëlushë, nuk kam nevojë për ndihmë, mund ta mbaj edhe vetë!  
Luli dhe luani mbetën të habitur. Në këtë kohë vjen Agroni. Ai e shikon gjyshin).  
AGRONI - (Lulit e Luanit). E shikoni plakun që po lodhet dhe nuk e ndihmoni?!
- LULI - Ne i thamë ta ndihmonim, por ai nuk pranoi.  
AGRONI - Vërtetë?  
LUANI - E mbaj vetë, na tha.  
AGRONI - Po shkoj ta provoj edhe unë një herë:  
LULI - Shko! Shko! Do ta shohësh po nuk të tha edhe ty po ashtu!  
AGRONI - ( Duke iu afruar plakut). Gjysh!  
GJYSHI - ( Ndalon). Urdhëro, birë!  
AGRONI - Ta marr unë trastën?  
GJYSHI - (E vështron edhe Agronin, pastaj thotë). Posi jo. Faleminderit, bir faleminderit (Agroni merr trastën dhe niset bashkë me plakun. Luli dhe Luani habiten edhe më shumë).  
LUANI - Po ndihmën tonë pse nuk e pranoi?  
LULI - Sa çudi! Vërtet, pse nuk e pranoi?  
LUANI - nuk e di...  
LULI - As unë nuk e di...  
Agroni me gjyshin dalin nga skena. Pas pak hyn përsëri Agroni)

LUANI - Po vjen Agroni. E Pyesim?  
 LUANI - Agron!  
 AGRONI - Urdhëro!  
 LUANI - Eja këtu, eja!  
 AGRONI - Ç'më doni?  
 LULI - Pse ty ta dha trastën gjyshi, kurse neve jo?  
 AGRONI - Se njeriu kur nuk është i zoti të kujdeset për vete, nuk ka si të jetë i zoti të kujdeset për të tjerët.  
 LULI - Unë nuk po të kuptoj.  
 LUANI - As unë.  
 AGRONI - Nuk shikoni si jeni bërë? Pis fare, tërë baltë. Edhe bluzat i keni pis. Prandaj, gjyshi nuk e ka pranuar ndihmën tuaj. Çfarë ndihme do t'i jepni ju? E kuptuat tani?

*R. Pasmaçiu*

### T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

trastë - strajcë, torbë

kur njeriu nuk është i zoti - kur njeriu nuk është i aftë

### Të lexojmë bukur

Lexojeni pjesën sipas roleve!

### Bisedim

- Cilët janë prestarët e dialogut?
- Ç'gabim bënë Luani dhe Luli?
- Ç'kuptojmë me fjalët e Agronit: "Çfarë ndihme do t'i jepni ju kur nuk jeni në gjendje të kujdeseni për veten tuaj".

### Detyrë

1. Luajeni pjesën teatrale dhe dallojeni grupin më të mirë.
2. Shkruani për çdo rol nga një fjali.

## Mësojmë gjuhën

### DREJTSHKRIMI FJALËVE

asgjë, kurrgjë, asnjë, asnjëri, asnjëra, askush, askurrkush, kurrkush, kurrkund, kurrsesi

### BENI DHE HARTIMI I TIJ

Beni kishte bërë një hartim. Ai në fletore e kishte shkruar kështu:

As njeri s'duhet t'i shkelë rregullat e ecjes në rrugë. Shoferi s'duhet të niset kurr kund pa pasur frenat në rregull. Fëmijët e vëmendshëm rrugës nuk i rrezikon kurr gjë. As kurr kush dhe as kush nuk po ecën jashtë vijave të bardha. Polici i tha: "Kurrsesi nuk duhet të luajmë në mes rrugës". Beni kishte plot gabime. Këto gabime kurr kush nuk i lejon.

#### Punë e pavarur

Gjeni gabimet dhe shkruani si duhet në fletoret tuaja.

#### Mbaje mend

Te fjalja Polici i tha: Fjalët e policit janë futur në thonjëza („”). Fjalët që përdorim kur i përsërisim pa kurrfarë ndryshimi fjalët e tjetërkujt i fusim në thonjëza. Po japim disa shembuj: „Po deshe nder, sillu me nder” ose Naim Frashëri ka thënë: „Punë, punë nat' e ditë që të shohim pakëz dritë”.

#### Detyrë

Gjeni dhe përshkruani disa fjalë nga revistat për fëmijë ku fjalët janë në thonjëza

## Bisedë për motivim

Bisedoni dikur kur nuk ka pasur telefona dhe celularë se si janë marrë vesh njerëzit ndërmjet vete.

### LETRA E GENTIT

“...Letrën tënde e mora. Shumë herë e laga me lot. Dola te currilat...U ula mbi një degë shkoze, u thash maleve: po bëhen tre muaj që nuk e kam parë tim vëlla të vogël... tre muaj... treqind vjet... tre mijë e më tepër...Ani, e motra e tretë po ia ruan një mollë të kuqe... E vëllai i dytë një vërrle të bukur.

Libri me këngë e balada të moçme, që më ke dërguar, e lexova. Më pëlqeu shumë balada e madhe për trimin e madh Gjergj Elez Alinë...që kishte mbrojtur tokat e kreshnikëve me topuz e shpatë, kundër armiqve të tërbuar të Bajlozit të Detit...

Të kisha thënë: Lexoje edhe një herë at këngë për trimin Gjergj që nëntë vjet, me nëntë plagë u dergj në kullë. E motra ia lau me ujë të gurrës e me lotët e syve...Shatin ia lidhte me pëlhurën e pambuktë të këmishave të nënës.

... Kam menduar edhe diçka.

E ççka?- do të pyesësh.

Sytë e mi t’i mbyll me një shami të trashë bojëkafe ...t’i mbyll fort...bile ta ndiej zërin tënd... E të bisedojmë... E të luajmë atë lojën:

Ti i vogël, unë i vogël,

Më lage, të laga,

Dushk për gogël.

Sepse më ka marrë shumë malli. Madje, le të preket faqja me faqe e dora me dorë...!”

Të do: Genti

*Gani Xhafolli*

### T’i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

currilat

• fije të holla uji a lëngu tjetër që dalin me forcë

vërrle

• lodër fëmijësh, që sillet në një vend

baladë

• lloj këngë popullore apo vjershë e dhimbshme



## Të lexojmë bukur

Në këtë letër autori e përdor shumë trepikëshin(...) Me të shënohet një pushim, një ndërprerje e shkurtër gjatë leximit. Prandaj kini kujdes kur ta lexoni.

## Bisedim

- Si e ka lexuar Genti letrën e shokut të tij?
- Çfarë i shkruan ai shokut të tij për librin e këngëve popullore?
- Kush është Gjergj Elez Alia?
- Përse mendon t'i mbyllë sytë Genti?

## T'i zgjerojmë njohuritë

Letra të bukura e qarta mund të shkruajë vetëm ai që e njeh mirë gjuhën në të cilën shkruan. Qe të arrihet kjo, duhet punë e vazhdueshme, sidomos duhet të lexohen libra.

## Detyrë

- Shkruani një letër një shoku të një shkolle tjetër

## Bisedë motivuese

Mësuesja dhe mësuesi për nxënësit janë prindër të dytë. Ato ju duan shumë. Nderimi i nxënësve ndaj jush është tepër i madh. Cili është nderimi më i madh për ju? Sigurisht përgjigja është kur ato mësojmë.

## TA DUAM E TA NDEROJMË

### I

Natën deri vonë.  
Mësuesja punon,  
Se detyrat tona  
Merr i kontrollon.

### II

Si të jemi bashkë  
Me ne kuvendon:  
“Turp për ty Zamir,  
Katër meriton!

### III

Po ty, moj Marigonë,  
Vallë, ç’të mungon?!  
Me këto shkarravina,  
Pse më dëshpëron?

### IV

Shikoje Diellzën,  
Ta kesh po zili;  
Sa bukur, sa pastër,  
Merr shembull edhe ti...”

### V

Her’ shum’ e gëzuar,  
Her’ me dëshirim  
Me ne flet mësuesja;  
Për ne jetën shkrin.

Moisi Zalloshnja

## Bisedim

- Çka bënë mësuesja deri vonë?
- Pse u dëshpërua mësuesja ndaj Marigonës?
- Çfarë krahasimi bëri mësuesja ndërmjet Zamirit dhe Diellzës?

## Ushtrime të të shprehurit

Si e kuptoni strofën e fundit:  
“Her’ shum’ e gëzuar,  
Her’ me dëshpërim Me ne flet mësuesja;  
Për ne jetën shkrin”

## Detyrë

1. Mësojeni vjershën përmendsh!

### Bisedë motivuese

Në klasë e sillni një kasetë me këngë kurbeti ose ndonjë libër ku janë mbledhur këngët e këtilla. Dëgjoni ose lexoni ato para nxënësve. Bisedoni mbi të këqijat e kurbetit si malli ndaj familjes, fëmijëve, nënave, vendlindjes etj.



## MALLI PËR BABAIN

Gjysh, tregomë diçka,  
Gjysh, tregomë një përrallë,  
Po mërzitem shumë,  
Babin s'e kam parë.

U mbushën nëntë muaj,  
Dhe i dhjeti po rrjedh,  
Nga vende të largëta,  
Babi ende s'erdhi!

Gjysh, tregomë diçka,  
Gjysh, tregomë një përrallë,  
Le të kalojë koha  
Se u dogja në mall!

*Jusufzija Ademi*

### Bisedim

- Pse mërzitej nipi?
- Sa kohë ka që djalin e ka marrë malli?
- Pse djali i kërkon gjyshit t'i tregojnë një përrallë?

### Detyra

1. Tregoni nëse keni ndonjë të afërm jashtë vendit se si komunikoni ju me të!
2. Shkruani cila do të ishte dëshira e jote që babai të të sjellë diçka nga kurbeti.

## Bisedë motivuese

Shpeshherë shumë gjëra edhe pse nuk janë ashtu ato duke u përcjellë rriten saqë është e pamundur të mos besosh. Prandaj bisedoni për ndonjë ndodhi se si është kuptuar ajo nga të tjerët.

## PËRRALLA NDJELLAKEQE

Në lashtësi bota e ndarë në shtete të panumërta. Çdo shtet ndahej nga tjetri me vargonj të maleve, deteve e të lumenjve.

Banorët e një shteti nuk njihnin banorët e shtetit tjetër, prandaj për ta fshehur këtë mosnjohje, flisnin gjithfarë fjalësh, gënjeshtërash dhe përrallash. Më këto të pavërteta kishin shkuar aq larg sa thonin se banorët e një shteti fqinj ecnin me kokë poshtë e këmbë lart. Kështu për shembull, të parët thonin se ata të shtetit tjetër kishin hundë të gjata, të dytët këmbët të shkurtra, kurse të tjerët sërish përgjonin duke thënë se ata të shtetit tjetër lere që s'kanë veshë, por nuk kanë as sy. Në secilin shtet flitej e përflitej zi me zi për banorët që jetonin përtej detit, maleve apo lumenjve. Banorët e njërit shtet thuhej se kishin dhëmbë elefantësh, të tjerët bishta kuajsh, e të tjerët ishin fare torollakë.

Nga kjo ftohje mesh shtetesh u shkaktua frika nga njeri-tjetri dhe mu për këtë askush s'kish guxim të kalonte kufijtë e shtetit tij.

-Kush? Telendasit? Ata janë hajdutë, dhelparakë!-u thoshin fëmijëve të tyre prindërit nga Fonopolisa.

-Banorët e Fonopoles që nga lindja janë mashtrues dhe hanë mish macesh-vazhdonin t'u flisnin myshterinjve të tyre tregtarët nga vendi i Ftohtësive.

-Në shtetin Cilidoqoftë për drekë hanë buburreca, kurse për darkë kërcëj. Uh! Sa neveritem kur i kujtoj- shtireshin sikur u vinte ndot banorëve të shtetit Kukurekas.

Dhe, kështu: për të parët flitej se ishin të egër, të tjerët bjerrakohës, e banorët e një shteti tjetër ishin gënjeshtarë. Kjo përrallë ndjellakeqe ishte përhapur me shembuj të ndyrë për njërin-tjetrin. Nga këto thashetheme shtetet mbylleshin e mbylleshin në guacat e tyre.

Një ditë një fëmijë kureshtar nga shteti Vërshongëzimi, pasi dëgjoji shumë përralla të tilla se banorët e një vendi Kushediku kanë brirë në ballë e në maj të bririt nga një sy dhe se ecin këmbadoras, dëshiroi t'i njohë këta njerëz njerëz kafshë.

Duke kaluar kufirin mu kur kufitarët i kishte zënë gjymi, djaloshi arriti në majë të një bregoreje, që jepte ballë mes shtetit fqinj dhe atij fqinj.

Nga kjo bregore vogëlushi pa livadhet e gjera e të lulëzuara të shtetit tjetër. Pa edhe shumë vashëza e djem të gëzuar që po mblidhnin lule.

-Po këta qenkan fare si ne! - i habitur tha vogëlushi na Vërshengëzimi duke shikuar me kureshtje vocërrakët e shtetit Kushediku.

*Gjokomo Skoti*

## T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

gënjeshttrash	• rrenash
përgojonin	• i mermin nëpër gojë
përflitej	• thuhej
torollak	• i trash nga mendja

Emrat e shteteve: Cilidoqoftë, Kukurekas, Kushediku, Vërshengëzimi janë emra shtetesh të menduara nga autori.

## Bisedim

- Çfarë mendonin njerëzit e njërës anë për anën tjetër?
- Kush e kishte krijuar atë bindje për njerëzit dhe çfarë qëllimi kishte?
- Çfarë bindje fitoi vogëlushi nga shteti i Vërshengëzimit?
- Cila është porosia e këtij teksti për marrëdhëniet ndërmjet njerëzve me shumë kombe?

## Detyrë

Shkruani një hartim me temën: “Nderoje tjetrin me të gjitha vetitë që i ka, që të jesh i nderuar edhe ti”!

## Bisedë motivuese

**Bisedën e fillojmë me pyetjet: Si argëtoheni ju sot? Përveç Iojërave fëmijërore që janë më të zakonshmet, a keni bëhet me shokët e lagjes xhitë. Ajo që ngrihet lart në qiell. Kush di të tregojë si bëhet ajo? Në cilën kohë ato ndërtohen? Me çfarë emri e quani ju?**

## LETËR NGA LARG

Liza shfletonte një libër të bukur me ilustrime. Në faqet e librit ishte një dyqan i tërë me lodra të ndryshme: avionë, vetura, kompjuterë, shtëpiza me kopshte përpara, një ari i vetmuar në pyll, një ujk në pritë duke përgjuar një dele...

-Sa libër i bukur! Duke e shfletuar librin në faqen e njëmbëdhjetë Liza pa një kokë të çuditshme fëmije.

-Sigurisht ky është indian,- mendon Liza në fillim. Por më vonë e ndërron mendimin. -Ky kështu nuk mund të jetë indian. Sigurisht kanë ngatërruar diçka këtu. bënë cilin vend të botës mund të gjendet kokë fëmije gjashtëkëndëshe?! Njëmend e paskan tepruar. Kjo nuk është as fytyrë fëmije, as kokë plaku, as lule. Kjo nuk është asgjë.

Vajza e habitur i drejtohet të atit:

-Baba,ç'na qenka kjo kokë e çuditshme?

Babai e mori librin në dorë dhe filloi ta shikojë vizatimin. Shikon, shikon e mandej edhe ai fillon të mendoj për diçka. Qe, edhe buza filloi ngapak t'i qeshet.

-Kësaj i thonë xhitë, Lizë. Është lodër fëmijësh.

Po ta lëshosh në qiell kjo fluturon.

*Ramadan Zejneli*

## Bisedim

- Cilin libër e shikonte Liza?
- Çka pa në libër?
- Si iu duk një vizatim?
- Kush ia shpjegoi vizatimin?

## Detyra

1. Lexoje pa zë.
2. Kërkoje në biblioteken e shkollës librin me titull "Koprraci i mbretërisë së hënës" që shkrimtari e ka shkruar për ju. Kërkoje, sepse aty ka tregime të tjera të bukura.



## Të flasim për gjuhën

### MBIEMRI

#### MOLLA E ARTË

Një herë një mbret përhap fjalë në tërë mbretërinë: “Atij që do të më thotë gënjeshtërën më të madhe do t’i jap një mollë të artë”!

Erdhën plot njerëz, që rrëfyen shumë gënjeshtër, por mbreti u thoshte atyre: “Qenkan të gjitha të bukura, por kush më siguron mua që nuk janë të vërteta?”

Një ditë te mbreti erdhi një fshatar, i cili i tha:

-Madhëri kthemi florinjte e mi!

-Florinjte?- u habit mbreti.

-Po m’i more javën e kaluar.

-Gënjen, s’te kam marrë asgjë-bërtiti mbreti.

-Nëse kjo qenka gënjeshtër,-ai priti burri,-atëherë urdhëro të ma japin mollën e artë!

Mbreti krenar e finok s’ deshi të dorëzohej. Bëri sikur iu kujtua:

-Ah po nuk më gënjen,- i tha burrit.- Më ke dhënë vërtetë ca florinj një javë më parë.

*Përrallë popullore*

Nga përralla “Molla e artë” i kemi nënvizuar këto fjalë: e artë, madhe, krenar, finok, të bukura etj. kanë një veçori të përbashkët - tregojnë veti të emrave me të cilat janë përdor. P.sh. mollë e artë, burrë i mençur, mbret krenar. Molla mund të jetë edhe kuqe, e ëmbël, e thartë. Burri mund të jetë i mençur, i fortë, i bukur, i gjatë, i pasur, i varfër, i hijshëm, kokëtrashë. Mbreti mund të jetë zemërbardhë, i egër, gjakatar etj.

**Të gjitha fjalët që shprehin veçori të emrit quhen mbiemra.**

#### **Detyrë**

1. Nëstrofën e dhënë gjeni mbiemrat: *Gjuha jonë sa e mirë,  
Sa e ëmbël, sa e gjerë.  
Sa e lehtë, sa e lirë,  
Sa e bukur, sa e vlerë!*
2. Shkruani pesë fjali me mbiemra

## Bisedë motivuese

Bëni një vizitë në qytet ose në fshat. Shikoni ndonjë mulli që punon me ujë. Vizitoni mullirin që punon me korent. Shihni si përgatitet mielli.

## NINULLA E MULLIRIT

Gjyshi me nipin pasi zbritën mes gurëve nëpër një dhiare, hap pas hapi arritën te lumi. Gurgullima e ujit mes atyre maleve i thirrte me këngë. Po vala me një degë me gjethe që ecte gur më gurë? Fuqia e lumit pa ua vënë veshin udhëtarëve me një dorë i rrotullonte, shpejt e shpejt, që mullisi plak me ato duar të fuqishme malësori ta shtijë i gëzuar miellin në thes. Që nesër buka që do të gatuhej në katund ta gëzonte gjithë vegjëlënë...

Nënë...Fëmijën në djep...

Djersa e lumit trokiste shtëpi më shtëpi

-Gjysh, kujt i këndon mulliri?

-Maleve me lisa, o nip!. Arave me grurë...Luleve në livadhe...Zogjve nëpër degë...

Fluturave me pika...Shkollarëve mbi libra...Fëmijëve në djepa...Atdheut me trima...

-Mulliri qenka, o gjysh, këngëtar i maleve! Kënga e tij ec gojë më gojë...

-Po, o nip! Mulliri këndon këngën e burrave. Lisat sa herë që kanë dëgjuar zërin e tij janë bërë kokë më kokë...Lulet janë rrokur në valle...Bariu i ka rënë fyellit...Burrat krah për krah janë ngjitur maleve...

Gjyshi e rroku nipin për qafe si shok dhe vazhduan rrugën krah për krah.

## Fjalë dhe shprehje

- dhiar                   • rrugë e ngushtë, rrugë e dhisë.  
gojë më gojë       • ka kuptimin e vazhdimit, kalon prej njërit te tjetri.

## Bisedim

- Ku e çoi rruga gjyshin dhe nipin?
- Cilët do të gëzonte mielli?
- Ç'kupton ti me fjalët: "këngëtar i maleve"?
- Kujt u këndonte mulliri?

## Detyrë

Gjeni pjesë ku ka dialog dhe përshkruani në fletore.





## Bisedë motivuese

Ora e matematikës për nxënësit është e dashur, por nëse atë e organizojmë nëpërmjet lojës. Gjithsesi duhet t'i ikim rutinës dhe traditës së vjetruar. Filozofët e vjetër thonë: "Ai i cili shkruan bukur në gjuhë, e shkruan edhe gjuhën e matematikës: shkronjat janë trekëndëshat, rrathët dhe figurat tjera gjeometrike"

## ORA E MATEMATIKËS

Kur vinte ora e matematikës, nxënësit e shkollës së pyllit dridheshin. Matematika u dukej e vështirë, më e vështira e të gjitha lëndëve. Më të lehtë e kishin të ngjiteshin nëpër pemë apo të fluturonin në qiell se sa të zgjidhnin ushtrimet e matematikës.

-Dy edhe pesë, sa bëjnë? - pyeste lepurushi qukapikun.

Mendohej ta gjente qukapiku, por më kot. Edhe ky lepurushi çfarë shoku ishte. Nuk e kthente pak tabelën sa ta kujtonte se sa bëjnë pesë edhe dy.

Lepurushi e kthente paksa tabelën e vogël të drunjtë nga qukapiku edhe ky përmen-dej. -Shtatë bëjnë. Pesë edhe dy bëjnë shtatë. Ah, si e kishte ngatërruar. Gjithnjë mësonte përmendësh.

Vetëm ketrushi e priste me padurim orën e matematikës, i dukej si lojë. Asnjëherë nuk gabonte. Edhe mësuesja çuditej. Ketrushi për ta mësuar mirë matematikën kishte krijuar një numëratore me lajthia.

-Dy edhe tetë bëjnë dhjetë. Gjashtë edhe katër bëjnë dhjetë. Një edhe tre edhe gjashtë bëjnë dhjetë.

Ketrushi hapi thesin dhe filloi t'u hidhte lajthia shokëve të tij. Duke vrapuar e kërcyer për të kapur lajthia, ato nuk e kuptonin nëse po përgatisnin ushtrimet apo luanin. Tanimë nuk e kishin vështirë ta kuptonin pse për ketrushin matematika ishte lojë.

### Fjalë dhe shprehje

ketrushi - ketri

qukapiku - zog që ka sqepin dhe bënë vrima në dru për të ngrënë krimbat.

### Bisedim

- Tregoni cilët ishin ata që nuk e donin orën e matematikës?
- Pse ketrushi e priste me padurim orën e matematikës?
- Si e mësonte ketrushi matematikën?
- Kur e kuptuan lepurushi dhe qukapiku se për ketrushin matematika ishte lojë?

### Detyrë

1. Rikallëzoheni tregimin.

*Përpunuar nga Vëllezërit Tafa*



## Punë paraprake

Nxënësit duhet ta kuptojnë se pse njerëzit shkojnë në kurbet? Kurbeti është plaga më e madhe, më e pashërueshme dhe më shqetësuese. Arsyet janë të shumta: në vendlindje nuk ka tokë pune, nuk ka punësime, nuk mund të gjejnë punë sipas zanatit që ai njohin. Në fillim shkojnë individualisht, e pastaj edhe me familjet e tyre.

## BINJAKËT

Greta dhe Ariani janë binjak. Ata janë nga Maqedonia, nga një fshat i vogël në rrëzë të malit të Sharrit. Po, që prej tre vjetësh ata jetojnë në Zvicër. Të dy shkojnë bashkë në shkollën “Nord”, dhe mësuese kanë zonjën Frei.

Babai i Gretës dhe i Arianit ka shkuar në Zvicër prej kohës, sepse në vendin e tij nuk gjete dot punë. Më parë fëmijët me në nënën në shtëpinë e xhaxhait. Aty jetonin edhe gjyshërit e të afërmit tjerë, kushërinjtë e kushërira të tyre.

Gretën dhe Arianin i kishte marrë malli për vendlindjen, ndaj ishin të gëzuar që pushimet verore po afronin. Si çdo vit, edhe këtë herë, ata do të shkonin për dy javë në shtëpinë e prindërve për të parë njerëzit e afërt, shokët dhe shoqet si dhe fshatin e tyre.

*Femzi Braha*

### Fjalë dhe shprehje

binjak - ai që ka lindur njëkohësisht me një tjetër nga e njëjta nënë  
në rrëzë - brezi i fundit i një mali

### Bisedim

- Pse ishte shpërngulur (larguar) nga vendlindja babai i Gretës dhe Arianit?
- Para sa viteve Greta dhe Ariani kishin shkuar te babai?
- Ata mësonin në shkollë. Në cilën gjuhë mësonin ata?
- Për çka i kishte marrë malli Gretën dhe Arianin ?

### Detyra

1. Përshkruaje familjen tënde të ngushtë.
2. Thuaj gojarisht, e pastaj shëno në fletore :  
vëllai i babait, motra e babait, motra e në  
e babait, baba i babait, vëllai i nënës.  
Lidhshmëri  
Këtë tregim mund ta shfrytëzoni edhe në  
lëndën N.SH. mbi temën:  
“Familja dhe farefisi”.

### Fjalë e urtë

Bukë e hi në shtëpi



### Bisedë motivuese

Bisedën e filloni me nxënësit mbi temën shoqëria. Mund t'i pyetni nxënësit se kush e kush janë shokë dhe shoqe. Pse ata dëshirojnë të rrinë bashkë? Shpeshherë ndodh që të qortohen ndërmjet veti për shumë arsye. Gjeneratën e re pyetni se si ka ndodhur juve në klasë me gjeneratat e mëparshme.

## QENË PESË GOCA

Qenë pesë goca, gishta dore,  
të pandara, shumë gaztore:

Dona, Imja-prinin në mësim  
Vala, Bardha-në këngëtim  
ndërsa Besa që syze mbante  
nxiste të bëjnë debate

për çdo çështje...dhe për detyra  
kjo dallohej si më e mira.  
Po një ditë, ky farë shoqërimi  
pësoi një rënie rrotullimi:

Në një klub, i nxënë kokat  
pikë e pesë na u bënë gocat:  
njëra: " ikim"! , tjetra: " rrimë"! ,  
njëra : " lozim"! , tjetra: pimë (!)  
ndërsa e pesta, s, dukej fare.

*Nuhi Veselaj*

### Fjalë dhe shprehje

goca - vajza  
gaztore - të gëzueshme, të qeshura  
debate - diskutim, shprehin mendime  
ikë e pesë - u shpëmdanë, s'mbeti asgjë  
bashkë

### Bisedim

- Tregoni emrat e tyre dhe me çka dalloheshin ata?
- Ku e tregonin ata shoqërinë e tyre?
- Pse u zunë? Cili ishte shkaku i zënies së tyre?

### Detyra

Mësojeni vjershën përmendsh.



## Punë paraprake

Bisedohet lirshëm me fëmijët. Si e kalojnë kohën kur mbeten vetëm në shtëpi. Nxitni me pyetje të ndryshme. Përveç lodrave, që janë të dedikuara për fëmijët, a i përdorin orenditë, enët, aparatet e ndryshme dhe shumë mjete që ndodhen në shtëpi për të luajtur. Bisedoni si sillen në shtëpi kur janë pa prindërit. Si i kanë befasuar ndonjëherë prindërit?

## ÇAMARROKËT

Diellza dhe Arditi janë dy fëmijë binjakë, aq të shkathët sa që të gjithë i thërrasin “çamar- rokë”. Kur prindërit janë në shtëpi, çamarrokët nuk bëjnë edhe aq zhurmë, por sapo prindërit largohet, ata nuk përmbahen dhe e kthejnë shtëpinë, përmbys. Edhe sot prindërit u larguan për një vizitë tek teta Landa.

Çamarrokët ndryshe nga gjithë fëmijët e tjerë që u qepen prindërve pas si manare, nuk donin të shkonin tek teta Landa. Sapo prindërit zbritën nga shkallët e pallatit, të dy çamarrokët fil- luan nga rrëmuja. Befas kur ata ishin në kulmin e “betejës”, ra zilja. Mama- ja kishte harruar diçka në shtëpi dhe ishte kthyer nga rruga. Çfarë të shikonte?! Arditi atë çast ndodhej mbi kalin lodër si të ishte një kalorës i kohërave të largëta, kurse Diellza po e sulmonte si në skenat e filmave historikë. Edhe ajo kishte veshur mburojat dhe kishte marrë armët e luftës. Ju me siguri e merreni me mend se armët dhe mburojat e tyre kishin enët e gjellës, fshesa apo lodrat e tjera. Kur panë mamanë nuk po u besonin syve. Për një çast u përpoqën ta rregullonin shtëpinë, por kjo ishte e kotë. Përpara ma- masë qëndronin kokëu- lur dhe përpiqeshin kush e kush të ia hidhte fajin njëri tjetrit.

### Fjalë dhe shprehje

binjak - fëmijë që ka lindur njëkohësisht me një tjetër

çamarrok - fëmijët e vegjël

manare - fëmijë i urtë, që nuk u ndahet nga prindërit befas-pa pritur

skenat- pjesa e ngritur e teatrit

mburojat-pllakë e madhe për tu mbrojt nga kundërshtari qëndronin kokëulur- qëndronim me turp

### Bisedim

- Pse çamarrokët dallohen nga fëmijët e tjerë?
- Kur nuk janë prindërit në shtëpi çka bëjnë çamarrokët?
- Çfarë pa mamaja kur u kthye në shtëpi?
- Cilat mjete shtëpiake i përdorin çamarrokët?

### Plani për punë të pavarur

1. rrëmuja
2. kulmi i betejës
3. faji

### Detyrë

Përshkruaje një ndodhi në familjen tënde.

*Vëllezërit Tafa*



### Bisedë motivuese

Nxënësit mund të tregojnë ndonjë rast ose ndodhi. Bisedohet lirisht rreth qëndrimeve që mbajnë ata ndaj fajit që e bëjnë vetë ose ndaj ndonjë shoku, qoftë në familje ose në shoqëri.

## MOS E FSHEH FAJIN

Një djalë i vogël kishte vajtur në shtëpi të gjyshes, e cila e donte fort. Duke luajtur në një dhomë vetëm theu një pasqyrë, të cilën e dinte se gjyshja e donte shumë. Për të mos u dukur faji i tij, doli pa zhurmë dhe mbylli derën. Sado që dora i dhembte shumë e i rridhte gjak nga një copë xhami që i kishte hyrë kur u thye pasqyra, ai duroi dhe s, i tha gjë fare.

Gjyshja, kur pa pasqyrën e thyer, u dëshpërua shumë dhe zuri të qortonte njerëzit e shtëpisë. Mirëpo, asnjëri s'ë merte fajin përsipër. Të nesërmen, në mes të natës, e ngritën nga gjymi: "Shpejt, se është nipi i sëmur". E gjora plakë nxitoi me të shpejtë. Kur ç'të shih-te? Nipit i ishte ënjtur dora shumë.

E pyeti nga se u bë dora ashtu, po djali s'tregoi.

Atëherë gjyshja filloi t'ia shikonte dorën. Kur e gjeti copën e xhamit në dorë, e mori vesh punën. Si ia nxori e ia lehtësoi pak dhembjen, i tha:

-O birë! Edhe një herë mos e fshih fajin që bën, se kështu bën një faj më të madh. Pasqyra ime s, ishte më e vlefshme se ti, po ngaqë ti e fshehe fajin unë qortova njerëzit kot. Po edhe ty pa shiko si t'u bë krahu, se s'na the që me kohë të ta mjekonin menjëherë.

### Fjalë dhe shprehje

qortonte - shante

gjora - e mjera

nxitoi - shpejtoi

e mori vesh punën - e kuptoi

### Bisedim

- Ç'faj bëri djali i vogël te gjyshja?
- Si veproi djali pasi e theu pasqyrën?
- Nga e kuptoi gjyshja fajin e djalit?
- Po si veproni ju kur bëni ndonjë faj pa dashje?

### Plani i punës në grupe

1. djali luante vetëm në dhomë
2. dëshpërimi i gjyshes
3. qortimi i anëtarëve të familjes
4. fshehja e gabimit
5. sjellja e gjyshes ndaj nipit

### Detyra

1. Tregoni gojarisht po ju si veproni kur bëni ndonjë faj pa dashje?
2. Tregoni gojarisht si sillen prindërit kur ju e tregoni apo nuk tregoni fajin.
3. Përshkruani në fletore cilat fjalë do t'i përdorni për faljen e gabimeve.

## Bisedë motivuese

Me nxënësit vizitohen disa mjeshtri dhe profesione. Pastaj bisedohet për shkollën që duhet të kryhet, mjetet me të cilat ata punojnë.

## Ç'DO TË BËHEM

Në u bëfsha traktorist,  
murator, elektrikist,  
gjeolog e infermier  
do të punoj kudo me nder.

Po të bëhem aviator,  
marinar, a murator,  
do të punoj unë me gëzim,  
për lavdinë e vendit tim.

Në u bëfsha farkëtar,  
rrrobaqepës, këpucar,  
djersën time pa kursim,  
do t'ia fal Atdheut tim.

Seç do bëhem nuk e di,  
se akoma jam fëmijë,  
por sot duhet të mësoj,  
që të di si të punoj.

B. Rama

### Fjalë dhe shprehje

infermier - që e ndihmon mjeku

aviator - që e drejton avionin

marinar - që e drejton anijen

gjeolog - është dijetar që e studion përbërjen (historinë) e tokës

lavdi - do të thotë nder i madh

### Bisedim

- Në strofën e fundit gjenden këto vargje:  
“por sot duhet të mësoj,  
që të di si të punoj.”
- Çka kupton ti me këto fjalë?
- Po ty cila mjeshtri të pëlqen më tepër? Pse?

### Mësojmë gjuhën tonë

Kur nuk kanë lojëra, fëmijët mund të luajnë vetë me fjalë. Nga fjalët që tregojnë lëndë (objekte) - formoni fjalë që tregojnë mjeshtëri.

mur                      orë                      këpucë futboll                      dru                      udhë  
murator                      \_\_\_\_\_                      \_\_\_\_\_                      \_\_\_\_\_                      \_\_\_\_\_



### Punë paraprake

Në këndin e librit duhet t' u lihen në dispozicion nxënësve pamje dhe figura me mjedise pune, punëtorë, bujq, njerëz me profesione të ndryshme.

## NËNA MILINGONË DHE BRUMBULLI I ZI

Milingona punëtore hynin e dilnin me shpejtësi dhe të gëzuara në shtëpizën e tyre. Milingona nënë i vështronte me dashuri bijat e saj, të cilat vinin të ngarkuara me ushqime.

-Mirëdita, nënë!- u dëgjua një zë i trashë.

Nëna milingonë ktheu kokën dhe pa e habitur brumbullin e zi, që ecte duke lëvizur antenat e tij të gjata.

-Mirëdita, brumbull-iu përgjigj.

-Pse i mundon bijat e tua sot në këtë ditë të bukur? Lëri të dëfrenjë e të kënaqen! Ka kohë plot përpara për të punuar. Le të shijojnë natyrën, aromën e këndshme të luleve!- vazhdoi brumbulli me ngut.

-Vetëm një përtac si ti flet kështu, - ia ktheu nëna milingonë,- ne kurrë s, e lemë punën e sotme për nesër. Natyra e bukur nuk shijohet duke ndejtur, por duke punuar.

Brumbullit nuk i erdhi mirë nga këto fjalë. Ai u shtri në diell të ngrohej e të shikonte si punonin milingonat.

Pak nga pak e zuri gjumi. Kur hapi sytë, ishte kohë dreke.

Milingonat po hanin me shije e pranë njëra- tjetrës. Brumbulli i pa dhe e griu uria... Iu afrua milingonave dhe zgjati dorën.

-Më jepni dhe mua një çikë, - u tha,-se kam shumë uri.

Milingonat e vështruan në sy dhe qeshën.

-Ç, duhet të hash!- ia ktheu milingona nënë. Më mirë rri e shijo natyrën e bukur nën rrezet e diellit.

Brumbulli e kuptoi që e kishte tepruar.

Lëvizi prapa me përtesë dhe u largua pa bërë zë.

### Fjalë dhe shprehje

milingonë - është një mizë që gjithë verës mbledh ushqim

brumbull - një

aromë e këndshme - erë e këndshme

shijojnë natyrën - rrinë në natyrë, kënaqen me natyrën

e griu uria - e mori uria, u urit

## Bisedim

- Ç,po bënin milingonat punëtore ?
- Çfarë i tha nëna milingonë brumbullit të zi?
- Ç'bëri brumbulli kur punuan milingonat?
- Pse s'duhet ta lëmë punën e sotme për nesër?
- Çfarë mësoi brumbulli i zi nga milingonat?

## Plani i punës në grupe

1. Milingonat dilnin me shpejtësi dhe të gëzuara
2. Si e shijonin natyrën e bukur milingonat.
3. Si i kuptoni fjalët: “Vetëm një përtac si ti flet kështu”?
4. Ç'kupton me shprehjen “u largua pa bërë zë”?

## Detyra

Përshkruaje gojarisht punën e babait ose të mamasë në familje.



## Punë paraprake

Në klasë zhvillohet një bisedë për nxënësit që nuk i kryejnë detyrat, për nxënësit që vonohen në shkollë, për harraqët, për ata që nuk mërzhiten aspak, për ata që më tepër kohë kalojnë jashtë.

## PËRTACI

Tri her' pesë pesëmbëdhjetë!  
O! që erë e freskët fryen!  
Katër her' pesë njëzet...  
Asnjë shok brenda s'mbeti!

Pesë her' pesë...cicërimë,  
Gjithë zogjët gëzohen;  
Pesë her' gjashtë...ëndrrime,  
Në shkollë duhen mësimë.

Pesë herë shtatë...është e kotë  
Nuk mund të mësoj!  
Pesë her' tetë...se kuptoj!  
Nënë a më lë të shkoj?



### Bisedim

- Ç'kupton ti me fjalën "Përtac"?
- Çfarë detyre ka pasur fëmija përtac?
- Çka i duket përtacit më rëndë?
- Cila është dëshira e tij?

### Detyrë

1. Mësojeni vjershën përmendsh dhe recitoheni!
2. Shkruani numrat me shkronja prej 11-20.

Lidhshmëri: Me lëndën e matematikës. Përsërite edhe një herë dhe thuaje tabelën e shumëzimit me kërcime.

### Fjalë e urtë

*Njeriu që priton, kurrë punë të mirë s'mbaron.*

## Punë paraprake

Zhvillohet një ekskursion në kopshtin zoologjik, në pyll ose sillen në kopsht kafaze me zogj e, sipas mundësive, edhe figura me zogj të ndryshëm.

# ZOGU I VOGËL ME PENDË TË HIRTA

- Shkrimtari** Thonë se njëherë e një kohë bilbili nuk njihej dhe nuk dihej se ishte këngëtar i më i dëgjuar ndër zogjtë e shpendët.
- Shqiponja -** Si kryetar që më keni zgjedhur, unë nesër dua të shikoj dhe të dëgjoj të gjithë zogjtë dhe bashkë me ju do të vendos se cili zog do të jetë këngëtar më i mirë dhe më i bukur.
- Shkrimtari -** U përhap lajmi kudo. Nga të gjithë anët, ku ishin e ku s, ishin, zogjtë e shpendët u mbledhën te Pylli i Këngëtarëve. Aty kishte ardhur dhe sorra zeshkane, bile u afrua rëndë-rëndë dhe një pallua. Palloi kishte një zë të shëmtuar, që nuk e pëlqente askush, por sa të bukura i kishte pendët!
- Të gjithë filluan ta vështronin dhe ai krekosej e mburrej, duke u munduar t'ua merrte mendjen me bukurinë e tij.
- Të nesërmen, të gjithë ishin gati të provonin se ishin këngëtar të mirë e të bukur. Shpupurishnin pendët e tyre ngjyra- ngjyra që ndrisnin në rrezet e diellit dhe lëshonin cicërima, ciu-ciu-ciu-cërr.
- Filloi koncerti i mrekullueshëm i zogjve dhe shqiponja i dëgjoji të gjithë me radhë. Kur poshtë pemëve i zunë sytë palloin.
- Shqiponja -** Po ti, do të këndosh?
- Shkrimtari- Sorra -** Palloi u fry e ngriti bishtin ngadalë dhe e hapi si freskore. Sorra pëshpëriti: Ti je më i bukuri këtu, besoj se shqiponja do të na fal që nuk di të këndosh.
- Jepni një nga pendët më të bukura të bishtit si dhuratë. Askush nuk i ka bërë ndonjë dhuratë asaj, krra-krra.
- Shkrimtari Palloi, sa dëgjoji këto fjalë, u krekos me mendjemadhësi për para të gjithëve dhe lëshoi një zë të çuditshëm. Pastaj këputi një pendë të bukur nga bishti dhe ia dërgoi shqiponjës.
- Priti me kokë lart falënderimet, por për çudi, shqiponja nuk po e vështronte fare. Asaj nuk i pëlqeu aspak ai mburravec, që fryhej aty poshtë me puplat e tij të bukura.
- Po në këtë kohë u dëgjua një cicërimë e ëmbël dhe pas asaj filloi një këngën aq të bukur, sa të gjithë zogjtë pushuan.
- Shqiponja ngriti vështrimin e saj të mprehtë dhe vuri re, në mes të

	gjelbërimit të një peme, një zog të vogël ngjyrë gri, me bisht të murmë. Zogu këndonte e këndonte. Këndonte për vendin e tij, për fushat e gjelbëruara, për malet e larta, për pranverën e lulëzuar. Të gjithë ishin mahnitur. Shqiponja u kënaq dhe i ndritën sytë.
<b>Shqiponja -</b>	Sa bukur!
<b>Shkrimtari -</b>	Kur e mbaroi këngën, të gjithë zogjtë cicëritën me gëzim.
<b>Zogjtë</b>	Të lumtë, të lumtë na kënaqe!
<b>Shkrimtari -</b>	Shqiponja e pyeti:
<b>Shqiponja -</b>	Kush je ti, o zog i mrekullueshëm?
<b>Bilbili</b>	Jam Bilbili.
<b>Shkrimtari</b>	Tha zogu i vogël me pendë të hirta dhe uli kokën me druajtje.
<b>Shqiponja -</b>	Shumë bukur këndove, o bilbil, ti je zogu këngëtar më i mirë.
<b>Shkrimtari-</b>	Të gjithë u gëzuan.
	Kur më poshtë u dëgjua krakarritja e çjerrë e sorrës.
<b>Sorra</b>	Uf, aman, po ai s, është aspak i bukur.... me ato pendë të hirta!
<b>Palloi</b>	-(flet me inat e me mburrje) Tamam ashtu! Dhe...ai nuk këndoi aspak bukur. Pastaj unë ju dhashë edhe dhuratë të zbukuroni me të bishtin tuaj!
<b>Shkrimtari -</b>	Zogjtë u zemëruan nga fjalët e palloit, kurse shqiponja u ngrit në degë, tundi krahët me forcë dhe foli:
<b>Shqiponja -</b>	Penda e jote e ndritshme nuk mund të më pengojë të shohë të vërtetën. Merre mbrapsht. ky zog i vogël jo vetëm që këndoi më mirë nga të gjithë, por ai për mua është më i bukur, sepse është - ai që është i thjeshtë.
<b>Shkrimtari</b>	Dhe në këtë çast i vuri bilbilit në kokën e vogël një kurorë me lule. Penda e bukur e bishtit të palloi mbeti përdhe e pluhurosur. Askush nuk e preku. Kurse palloi mendjemadh iku i turpëruar së bashku me sorrën.

### Fjalë dhe shprehje

fluturimthi - shpejt e shpejt  
 vështronin - shikonin  
 shpurrpurisur - me pendla të shprishura  
 koncert - shfaqje, program  
 shëmtuar - jo i bukur, duket keq  
 pendë - pupël  
 pendë të hirta - pupla ngjyrë hiri  
 mahnitur - habitur  
 mburravec - ai që krenohej tepër, mbahej më të madh  
 pallua - zogj që kur i lëshon fletët, i ka me ngjyra

që fryhej me puplat e bukurac - krenohej me puplat e bukura  
i tundi krahët - i lëvizi krahët  
u afrua rëndë e rëndë - vinte ngadalë-ngadalë

### Bisedim

- Pse i mblodhi shqiponja shpendët?
- Pse i tha sorra palloit se ti je më i bukuri?
- Çka e mësoi palloin sorra?
- Cili ishte këngëtari më mirë?
- Çka mësojmë nga kjo përrallë?

### Plani i punës në grupe

1. zgjedhja e këngëtarit me të mirë
2. roli i shqiponjës
3. largimi i palloit dhe sorrës

### Detyra

Caktoni disa nxënës sipas pjesëve që u pëlqen që ta luajnë bashkë pjesën në skenë.

### Punë paraprake

Kur njerëzit nuk kanë çka të bëjnë netëve të gjata të dimrit, tregojnë përralla. Miqtë më të mirë të tyre janë fëmijët, kurse gjyshet dhe gjyshërit janë ata që i tregojnë. A di dikush ndonjë përrallë që e ka dëgjuar nga gjyshja ose gjyshi?

## PËRRALLA E PAMBARUAR

-Ishte një herë një mbret që dinte se ç'bëhej në tërë anët e dheut.  
-Ii,- ia priti Guri, - paska pas radio...  
-Pusho një herë, dëgjo njëherë!.. Ai mbret kishte një kalë që në drekë ishte aty dhe darkë shkonte pesë ditë larg..  
-Hëë, -u dëgjua prapë Guri,-ai paska pas aeroplan e jo kalë..  
-Çfarë “pllani”, dëgjo këtu tash! Kur donte t'i thoshte kujt gjë, s, dilte fare prej dhome, por fliste e tjetri e dëgjonte...  
-Hee, tani e di edhe unë, paska folur në telefon... -u ngut të thotë Guri.  
-Eh, eh, eh,- ia bëri plaka,- a po donë të dëgjosh?...Në shtëpinë e tij nuk ndizej kurrë zjarr...Sa herë që donte të ngrohej ose të zihej ndonjë send mbreti bërtiste: “Zjarr, ndizu! Gjellë zihu”..  
-Edhe këtë e mora vesh, -tha Guri,- ai paska pas shporet elektriku.  
-Vaj, për mua,- u ankua plaka,-s'po më le të tregoj...Ai kishte një djalë që shkonte në gjueti, por një ditë kishte humbur në pyll. Për ta kërkuar të birin mbreti dërgoi disa zogj të mëdhenj.  
-Uh, uh, uh,-bërtiti Guri,-ata sigurisht kanë qenë helikopter.  
-Gjyshja u hidhërua, por Guri e luti. Duke i kërkuar falje, më fal!  
Kur arrini djali në shtëpi të gjithë e morën vesh. Guri përsëri nuk iu durua më. U çua në këmbë dhe tha:-Atij i thonë televizor.  
- Kushedi zogu im, përralla u thoin ne kur ishim fëmijë.

*Tajar Hatipi*

### Fjalë dhe shprehje

këtë e mora vesh - këtë e kuptova

### Bisedim

- Pse gjyshja nuk i përmendte mjetet dhe aparatet e ndryshme me emrin e tyre?
- Trego cilat mjete dhe aparate i përmendte Guri.
- Cilat aparate dhe mjete i keni ju në shtëpi?

### Detyrë

Cilat numra të telefonave duhet t'i dini dhe shkruani në fletore.  
Lidhshmëri: me N.SH. në temën: “Aparatet e amvisërisë”.

## MËSOJMË GJUHËN

### PËREMRI VETOR

#### KORBI DHE DHELPA

Një dhelpër me dinakëri i thotë korbit:

-Unë e di që ti këndon mirë, po unë kam dëgjuar se yt vëlla këndon edhe më mirë se ti, përse nuk ia merr edhe ai këngës?

Korbi me djathë në gojë heshti, ndërsa tjetri iu përgjigj:

-Im vëlla vërtet këndon bukur, por ai nuk bindet lehtë edhe nuk dëgjon mirë, prandaj afrohu e ne po zbresim pakëz dhe unë do ta bind.

Dhelpëra u afrua nën korbin dhe ai ia lëshoi djathin në gojë. Ajo e gëlltiti dhe menjëherë iu skuqën sytë dhe nisi të villo.

-Ju qenkeni pa edukatë. Djathi paska qenë i prishur!

Ata ia morën këngës: Krra, krra, krra gjithë gëzim që ia punuan dhelpërës.

Fjalët **unë, ti, ai, ajo** i tregojnë vetat.

Fjalët që i tregojnë vetat quhen përemra vetorë.

Fjala **unë** tregon personin ose vetën e parë që flet.

Fjala **ti** tregon personin ose vetën e dytë me të cilin flasim.

Fjala **ai** ose **ajo** tregon personin ose vetën e tretë, për të cilin flasim.

Këta përemra janë përdorur në numrin njëjës, ndërsa në numrin shumës bëjnë pjesë: **ne** për vetën e parë; **ju** për vetën e dytë dhe **ata, ato** për vetën e tretë.

Mbani mend

Përemrat vetorë i kanë dy numra: numrin njëjës dhe numrin shumës

Veta	Numri njëjës	Numri shumës
I	unë	ne
II	ti	ju
III	ai, ajo	ata, ato

#### Detyrë

Në tekstin që e keni lexuar në orët e mëparshme gjeni përemrat vetorë.

## Bisedë motivuese

Merreni mendimin e disa nxënësve se kur shkojnë ata në shtrat. Kur atyre u flihet në mëngjes, a ndodh ndonjëherë që të shtiren si të sëmurë.

## PËRRALLA E GJYSHES

Gjyshja ,Gimi dhe Linda flenë në një dhomë. Ata përherë zgjohen herrët. Por, një ditë mëngjes Gimi s'ngrihej nga shtrati. Duhej të shkonte në shkollë. Ai nuk flinte, por ia kishte ënda të rrinte shtrirë. Gjyshja, si e pa se nuk po ngrihej, e afroi Lindën pranë vetes dhe i tha: -Të ta tregoj një përrallë, Linda!

-Na ishte, ç'na ishte. Në një fshat na ishte një gjel pendartë i cili mëngjes për mëngjes i zgjonte femijët nga gjumi. Një ditë një fëmije nuk i dilte gjumi...

Gjyshja këtu u ndal dhe shikoi kah Gimi. Ai shtirej sikur flinte. Gjyshja vazhdoi:

-Atë mëngjes gjeli këndoi e këndoi që t'i zgjojë fëmijët deri sa i ra pupla e artë. Pupla e artë i erdhi fëmijës në shtrat, e xigëloi në hundë dhe i tha: Zgjohu herët çdo mëngjes, laji sytë, bëjë gjimnastikë, ha mëngjesin dhe nisja punës...

Gimi u ngrit në këmbë dhe tha:

-Eu, sa vonë qenka bërë! - Pastaj iu drejtua gjyshes: - A mos flisje diçka gjyshe?

Gjyshja buzëqeshi.

Gimi mori librat dhe u nis për në shkollë. Tërë ditën Gimit i sillej përralla e gjyshes.

*Nehas Sopaj*

### Fjalë dhe shprehje

shtirej - bëhej

### Bisedim

- Kush janë njerëzit në këtë tregim?
- Çfarë përralle i tregoi gjyshja Lindës?
- Ç' tha Gimi kur u ngrit në këmbë?

### Plani për punë në grupe

1. Dhoma
2. Gimi në shtrat
3. Përralla e Gjyshes
4. Pupla e artë e gjelit
5. Buzëqeshja e gjyshes

### Detyrë

Të ritregojmë çfarë lexuam, duke u mbështetur në pikat e planit.



## Punë paraprake

8 Marsi është dita e nënave. Me këtë rast ju disa ditë para se të vijë kjo ditë përgatitni me nxënësit në klasë disa urime me materiale të ndryshme. Kërkoni ide nga vet nxënësit, kurse tekstin shkruajeni ju në dërrasë.



## URIME NËNËS

Një ditë duke u kthyer në shtëpi e pashë Shegën duke ecur më ngadalë se tjera herë. U habita. Në dorë kishte një fotografi. U afrova edhe më afër dhe zgjata sytë mbi supet e saj. Ajo më ndjeu dhe ktheu kryet, mandej e fshehu fotografinë. Unë qesha mbasi ec edhe pak më tha:  
-Një urim për nënën!

-Pse? A mos ka ditëlindjen?

-Jo

-Atëherë?

Ajo vëri buzën në gaz, shtrembëroi pak qafën dhe m'u përgjigj: Nesër është Tetë Marsi, dita e nënave tona, dhe unë ia kam përgatitur urimin me një kartolinë. Sa herë që vijnë festat e mia nëna më puth dhe më uron. Edhe unë dua t'ia uroj festën saj.

### Bisedim

- Tregoi shokëve dhe shoqeve se si ia ke uruar nënës tënde 8 Marsin!
- Me çka ia uroi Shega 8 Marsin nënës së saj?
- Si ia uron festat nëna Shegës?

### Detyrë

1. Shkruaj e një vjershë për nënën!
2. Bëre një hartim të shkurtër me këtë titull: "Si e gëzova nënën për 8 Mars?"



Shkrime joletrare

## NJOFTIM

Njoftojmë se grupi recitues i shkollës sonë do të përgatisë garë recituese ndërmjet nxënësve të shkollës sonë me qëllim që t'i zbulojmë talentët e rinj.

Të interesuarit duhet të paraqiten te kryetari i grupit recitues deri më 20 nëntor të këtij viti.

Kryetari i grupit recitues,  
Lis Mustafa

## FTESË

I ftojme të gjithë nxënësit e shkollës sonë që nesër, të shtunën, të marrin pjesë në pas-trimin e oborrit dhe në mbjelljen e fidanëve të drurëve zbukurues.

Drejtori i shkollës  
Dardan Kryeziu

## LETËR

E dashura Elona

Më ka marrë malli shumë për ty. Verën e ardhshme do të vij përsëri te ju për pushime.

Do të të tregoj shumë gjera të reja.

Të përqafoj, Alma  
Shkup, 15 tetor 2009

## TELEGRAM

Adresa e plotë e marrësit: *Alma Zajazi, Rr. "Shkupi", nr. 57, Kërçovë*

Teksti *Të uroj gëzuar 8 Marsin, nënë.*

Adresa e plotë e dërguesit: *Lis Zajazi, Rr. "Naim Frashëri", nr.20  
Shkup*

### Detyrë

Bashkërisht në grup shkruani një ftesë, një njoftim, një telegram.

### Bisedë motivuese

Kjo vjershë është paraparë për nxënësit që kanë prirje dhe talent recitues. Vjersha duhet të recitohet me rastin e 8 Marsit - Ditës së nënës

Ushtroni vjershën dhe recitoni bukur, pa u ngutur, duke i respektuar pushimet, theksat, tonin.



## MËMA

Fjalë e bukur, fjalë e shenjtë,  
Thellë zemrës që tingëllon.  
S'ka në botë gjë më të shtrenjtë,  
S'ka si mëma kur kujton.  
Mëmë, mëmë, frymë e lartë,  
Reze drite, hyll qiellor,  
plot mëshir, e mall të zjarrit.  
Kush s'di vlerën e njëj nëne.  
Është pa ndenj, e shpirtmizor,  
bir skëterre e frymë nëme.  
është, i vetes tradhtor!

*Asdreni*

### Fjalë dhe shprehje

shpirtmizor - zemërkeq, i keq  
skëterre - ferr, xhehenem  
nëme - mallkim

### Fjalë e urtë

Nëna është drita e shtëpisë

## Bisedë motivuese

Fëmijëve zakonisht nuk u hahet në mbrëmje. Dëshira e tyre më e madhe është ushqimi i shpejtë, sidomos sendiçat, tostat etj. Llojllojshmëria e ushqimeve dhe konsumimi i tyre është kulturë jetësore. Bëni një bisedë se çka dëshirojnë të hanë më tepër?.

## SUPE ME BARISHTE

Mami, babi dhe Shkëlzeni qenë ulur pranë tryezës për të ngrënë darkë. Diana vazhdonte të shihte në televizor një film vizatimor.

-Diana , ulu edhe ti bashkë me të tjerët,-e luti gjyshe Meri.

-Çfarë gjelle keni për darkë?-pyeti Diana.

-Supë me barishte, -i tha gjyshja,- Eja shpejt se kjo lloj gjelle nuk hahet e ftohtë. Diana u ul në karrige. Shikoi pjatën dhe rrudhi buzët. Nga pamja gjella nuk i pëlqeu. Ajo vuri re se Shkëlzeni po hante duke lëpirë buzët, sikur të ishte ëmbëlsirë.

-Supë më të shijshme se kjo, nuk kam ngrënë kurrë, -tha babai

-Të lumshin duart! - e përgëzoi mami gjyshen.

-Barishtet janë të mira për shëndetin, sepse kanë vitamina,- shtoi babai.

Diana futi lugën në pjatë dhe nisi të provonte. Supa iu duk e shijshme dhe e mbaroi shpejt.

Diana filloi të mendohet.

-Pse mendohesh? e pyeti mami.

-Asnjë vitaminë nuk e gjeta unë, - tha e pakënaqur Diana Prindërit qeshën.

Babi i shpjegoi Dianës se vitaminat e brishtave dhe të fryteve nuk dallohen me sy.

Vitaminat janë të dobishme për shëndetin.

*Naunt Prifti*

### Bisedim

- Çfarë kishte për darkë?
- Pse nuk iu pëlqeu për nga pamja?
- Si iu duk kur e provoje?
- Ç'kërkonte Diana në pjatë?

### Detyra

1. Bëni një listë të gjellëve që ju i doni dhe një që ju nuk i doni.
2. Çka di ti të përgatitësh? Shkruajeni recetën e gatitjes në fletore.



## Bisedë motivuese

Sjell në shkollë një tenxhere me kapak të mbushur me ujë dhe mësoni të vlejshëm. Pastaj bisedoni me nxënësit pse nga uji del avull, e pse nëse i vëmë kapak do të paraqiten disa pika uji. Nga oborri i shkollës shikoni mjegullat si ngrihen nga mali i afërt. Pastaj si fillon të bie shi. Uji i shiut që derdhet në tokë i formon përrockat e nga përrockat lumi etj.

## JETA E NJË PIKË UJI

Nuk e di se si erdha në botë, tha pika e ujit. Kujtohem, kur një mëngjesi të bukur pranveror. ) ja në një gjethe të gjelbër. Ishim më shumë në gjethe dhe afërme dhe të gjitha ndriçonim prej diellit të bukur të mëngjesit.

Me një herë më lëkundura era dhe rashë prej gjethe drejt në zemrën e një trëndafili, i cili kishte çelur. Kur ra dielli mbi fletët e trëndafilit u bëra më e vogël dhe diçka më ngrinte përpjetë. Pas pak kohe mora vesh se ndodhesha mbi gjethe dhe trëndafilit, por isha bërë avull uji. Duke u ngritur lart e më lart u takova me shoqet e mija dhe prej nesh u bë një re e kaltër.

Një erë e fortë më shtyri larg në ajrin e ftohtë. Ngrimë nga të ftohtët. Ne u mbledhëm dhe u shtrënguam njëra me tjetrën e prej kësaj mbledhje dolën ca pika uji. Ishim të rënda dhe ramë në tokë njëra pas tjetrës, rrëshqita dhe rashë për tokë. Shumë kohë ndodhesha së bashku me shoqet në tokë.

Duke udhëtuar u takova me shumë shoqe të mija dhe së bashku me forcë një ditë mundëm me dalur në dritë. Kur na panë njerëzit na thanë: Ja një burim i pastër! Me gëzim shpejtoja së bashku me të tjerët duke kërcyer gur mbi gur e gëzuar për lirinë dhe për diellin e ngrohtë.

Duke ecur arrita në rrëkenë më të afërme. Por edhe këtu nuk qëndrova gjatë. U nisa për nga përroi dhe më tutje për në lum.

Brigjet e lumit nuk më interesonin më shumë se peshqit, që luaja dhe notoja me to.

Prej lumit bashkë me shoqet e tjera arrita në dete. Atje gjeta shumë bimë të çuditshme, guaca deti dhe kërmill.

Jeta e ime nuk ka as fillim as mbarim; ajo është e përjetshme.

## Fjalë dhe shprehje

rrëke - rrjedhë e ujit që bëhet pas shiut, vijë me ujë

brigjet - vend që nuk është i sheshtë

## Bisedim

- Ku ndodhej pika e ujit?
- Kur ranë gjethe dhe trëndafilit, në çfarë gjendje kaloi?
- Tregoni në cilën gjendje ishte pika e ujit në ajrin e ftohtë?
- Kur u kthye në tokë, çka u formua nga shiu?
- Kur ranë tokë pikat e shiut, ku shkuan?
- Kur u kthyen përsëri, çka doli nga toka?
- Çka prej burimit u formua?
- Si e kupton ti mendimin: “Jeta e ime nuk ka as fillim as mbarim; ajo është e përjetshme”?

## Detyra

1. Ritregojeni kuptimin e copës së leximit.
2. Mendo dhe shkruaj një hartim në temën “Pa ujë s’ka jetë”!

## Lidhshmëri

Këtë copë leximi mund ta shfrytëzoni në N.Sh. gjatë përpunimit të temës: Ujërat rrjedhës.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit për insektet, që gjatë verës ndriçojnë natën

# HËNA DHE XIXËLLONJA

-Xixëllonjë, xixëllonjë,  
shko e fli, se u bë vonë,  
se do të shqetësohet nëna-  
një natë vere i tha Hëna.

Pyllit-o nuk i bënë dritë,  
rrugën tënde me zor ndrit;  
së shikon ti, dritën time  
oh, nuk ngjan më një thërrime...


-Hënëzo, moj Hënëzo  
mos shit mend, mos u kreno  
drita jote ka shkëlqim,  
drita xixë mban emrin tim...

Hëna iku, s'tha asnjë fjalë,  
e në pyll nuk hodhi dritë,  
Xixëllonja me fenerë  
e gëzuar ndrit e ndrit...

*Xhahid Bushati*

## Detyrë

Lexojeni në role



## Bisede për motivim

Nxënësve duhet t'u parashtrohen disa pyetje: Si duket koha kur pritet të bie shi?; Ç'bëjnë drurët, zogjtë?; Si duken mjegullat në qiell? etj.

## STUHIA

Qielli u err, u bë pus. Zagushia të mbyte.

Pylli dukej si i trishtuar e sikur s'merrte frymë. Shpesëria heshti.

Retë varën krahët e tyre të rënduar dhe pylli e ndjeu frymën e ftohtë e të lagur. Për një çast sundoi një qetësi, që të shtinte frikën. Pastaj pa prituri shpërtheu era e marrë. E ndien pishat dhe fishkëllyen me ankim; e ndihen ahet dhe u drodhën me trishtim. Diku thellë shkrepiti e ra rrufeja dhe bubullima e saj tronditëse u përsërit disa herë. Më pas ja krisi shiu pikë- madh me rrebesh e me potere. Era dhe shiu u bashkuan e u vërsulën me furi të madhe mbi pyll.

Brenda në pyll kërcisnin degët, thyheshin degëzat dhe dridheshin e qanin fletët duke lëshuar shiun në tokë si pika loti të mëdha e të dendura..

Nuk shkoi shumë dhe stuhia pushoi. Retë zunë të shpërndahen dhe dielli ndriçoi më me shkëlqim se përpara. Pylli u qetësua dhe shpesëria u gjallërua përsëri. Tani çdo gjë e gjallë, por edhe vetë toka, e ndjenin veten si të përtëritura.

### Fjalë dhe shprehje

stuhia - erë e shpejtë

zagushia - bulçim, vështirë merret frymë

ankim - rënkon, qahet

shkreptiu - kërciti

shpesëri- shpezë

furi- rrëmbyeshëm, tërbim, fuqishëm

### Bisedim

- Rilexojeni copën dhe ndajeni në tërësi logjike
- Ç'bëjnë retë dhe era?
- Si e ndien pylli?
- Ç'thuhet për pishat?
- Punë e pavarur në grupe
- Qielli
- Zagushia
- Pylli
- Shpesëria

### Detyra

1. Përshkruani fillimin e shiut.
2. Përshkruani ç ndodhë në pyll.
3. Përshkruajeni mbarimin e stuhisë.

## Mësojmë gjuhën tonë.

### Rendi i fjalëve në fjali (kryefjala + kallëzuesi + pjesë plotësuese)

**Fjalët:** bie shi, fryen era, nxënësi mëson, zogu këndon.. janë fjalë që tregojnë për veprimet që i bëjnë sendet dhe fenomenet e natyrës. Nga shembujt shohim se kemi të bëjmë me dy fjalë : p.sh. zogu këndon...njëra tregon kush e kryen veprimin (punën), kurse tjetra tregon çka kryen (cilën punë). Kështu kemi një lidhje ndërmjet dy fjalëve, por në fjali mund të gjenden edhe fjalë të tjera që i tregojnë kushtet në të cilat ndodhet objekti, tregojnë veprimin e objekteve ç'po bëjnë? P. sh. Nxënësi mëson + me dëshirë, zogu këndon + bukur,

**Shpjegim:** Nxënësi mëson (është fjali e thjeshtë), sepse e ka vetëm kryefjalën (Nxënësi) dhe kallëzuesin (mëson) + me dëshirë (është pjesë plotësuese) = Nxënësi lexo me dëshirë.

**Ose** Zogu + këndon + bukur = Zogu këndon bukur.

**Detyrë**

Shkruani nga tri fjali të thjeshta dhe të zgjeruara

## Bisedë motivuese

Nxënësve ju tregohet albumi me shpezë të ndryshme. Është mirë që zërat e shpezëve të ndryshme të jenë të incizuara në magnetofon. Duke i dëgjuar zërat, nxënësit tregojnë për cilën shpend bëhet fjalë. Natyra u ka krijuar shpendëve kushte të posaçme që të jetojnë, të ushqehen, të komunikojnë mes vete dhe të shumëzohen sipas zakoneve të tyre.

## ZAKONET E ÇUDITSHME TË QYQES

Një ditë Dea e vogël, duke luajtur në kopsht, pa në një ferrë një çerdhe të vogël sa një grusht me pesë vezë të vogël. Vezët ishin të verdha dhe ngjyrë të bakrit.

-Sa të bukura qenkan këto vezë pikaloshë dhe kjo çerdhe si kupë e vogël druri! Do të vij përditë që t' i shoh edhe kur të kenë dalë zogjtë e vegje, -tha Dea

Të nesërmen Dea, vajti prapë te çerdhja dhe zgjati kokën.

Njëra nga vezët atë ditë për çudi dukej më e madhe e nuk u shëmbëllente mirë të tjerave. Këtë ajo nuk e kishte vënë re më parë.

-Ç, jetë vallë kjo vezë? tha Dea dhe rendi shpejt te ungji.

Pas pak të dy bashkë me ungjin erdhën te çerdhja. Ungji i Desë dinte shumë gjera nga jeta e kafshëve dhe shpezëve, sa e pa vezën tundi kokën dhe tha:

-Kjo është vezë qyqeje. Katër të tjerat janë të gushëkuqit.

-Të lutem shumë,- i tha Dea të ungjit-më trego se kush e solli këtë vezë.

Ungji i Desë zuri t' i tregoj historinë e qyqes:

-Qyqja, ai zog që dëgjohet duke kënduar kuku-kuku tërë prillin e deri në fund të qershorit, është qyqja mashkull. Qyqja femër nxjerr një zë tjetër: kuk-kulk-kulk. Mashkulli dhe femra rrojnë të ndarë, nuk bëjnë çerdhe. Femra e lëshon vezën në ndonjë çerdhe të huaj ose e lëshon atë përdhe dhe pasi çel ajo të voglin e vendos në çerdhe të ndonjë zogu tjetër, që të ushqehet me insekte, si :gushëkuqi, bilbili, çoçri e të tjerë. Shumë here ajo e hedh jash-të njërën nga vezët apo zogjtë tjerë dhe vë të sajën brenda.

Çudi!-tha Dea.-Tani e kuptova se si u gjend kjo vezë në çerdhen e gushëkuqit.

## Fjalë dhe shprehje

çerdhe - fole

shëmbëllente - dukej

gushëkuqi - zog me gushë të kuqe

ungji - xhaxha

çoçri - e ka kuptimin e një zogu me trup të vogël

kupë e vogël - e ka kuptimin e një ene të vogël e të thellë

## Bisedim

- Ç'gjete Dea në gardhin e kopshtit?
- Çka i shpjegoi i ungji të nesërmen kur erdhi bashkë me të?
- Cili ishte shkaku që qyqja i vendosi vezët në çerdhe të huaj?





Mësojmë gjuhën

## FOLJET NDIHMËSE KAM DHE JAM

Lexojeni tekstin e mëposhtëm

### UNË JAM NË KLASËN E KATËRT

Unë **jam** në klasën e katërt. Arta sivjet **do të jetë** në klasën e pestë dhe për mësuese **do të ketë** Faraketën. Ata **kanë pasur** edhe një vëlla më të vogël. Ne nxënësit të tjerë me Artën dhe me Nardin jemi shok të mirë. Nxënësit **kanë qenë** në fushën e futbollit. Kur shkojmë atje **ne jemi** shumë të gëzuar. Nardi **ka qenë** çdo herë në ekipin e parë të shkollës. Nxënësit e shikojnë me kujdes lojën. Loja **do të jetë** shumë interesante. Andi dhe Gimi **kanë pasur** ushtrime të rregullta dhe **do të kenë** qejf të **jenë** në ekipin e parë të shkollës. **Është** kënaqësi të jemi të parët.

Në këtë copë na bien në sy disa folje të cilat janë shënuar me të zezë si p. sh. **jam, do të jetë, do të ketë, kanë pasur, jemi, kanë qenë, ne jemi, ka qenë, do të jetë, kanë pasur, do të kenë, jenë, është.**

Të gjitha këto folje janë formuar nga foljet **kam** dhe **jam**, që quhen **folje ndihmëse**, sepse u ndihmojnë foljeve të tjera të zgjedhohen. Por këto përdoren edhe si folje në vete: e para për të treguar **pasje**, kurse e dyta **qenie**.

#### FOLJA KAM

##### Koha e tashme

Unë kam  
Ti ke  
Ai(ajo) ka  
Ne kemi  
Ju keni  
Ata (ato) kanë

##### Koha e kryer

Unë kam pasur  
Ti ke pasur  
Ai (ajo) ka pasur  
Ne kemi pasur  
Ju keni pasur  
Ata (ato) kanë pasur

##### Koha e ardhshme

Unë do të kem  
Ti do të kesh  
Ai (ajo) do të ketë  
Ne do të kemi  
Ju do të keni  
Ata (ato) do të kenë

#### FOLJA JAM

##### Koha e tashme

Unë jam  
Ti je  
Ai (ajo) është  
Ne jemi  
Ju jeni  
Ata (ato) janë

##### Koha e kryer

Unë kam qenë  
Ti ke qenë  
Ai (ajo) ka qenë  
Ne kemi qenë  
Ju keni qenë  
Ata (ato) kanë qenë

##### Koha e ardhshme

Unë do të jem  
Ti do të jesh  
Ai (ato) do të jetë  
Ne do të jemi  
Ju do të jeni  
Ata (ato) do të jenë

## FOLJA KAM

### Koha e pakryer

Unë kisha  
Ti kishe  
Ai (ajo) kishte  
Ne kishim  
Ju kishit  
Ata (ato) kishin

### Koha e kryer e thjeshtë

Unë pata  
Ti pate  
Ai (ajo) pati  
Ne patëm  
Ju patët  
Ata (ato) patën

## FOLJA JAM

### Koha e pakryer

Unë isha  
Ti ishe  
Ai (ajo) ishte  
Ne ishim  
Ju ishit  
Ata (ato) ishin

### Koha e kryer e thjeshtë

Unë qesh  
Ti qe  
Ai (ajo) qe  
Ne qemë  
Ju qetë  
Ata (ato) qenë

## Ushtrime

1. Plotësojeni tekstin me foljet **kam** ose **jam** në kohën e kryer të thjeshtë Mbrëmë... në shfaqje. Programi... mjaft i pasur... këngë e valle popullore. Shpesh, duartrokitjet... e gjata. Aktorët luanin mirë
2. Ndani fjalitë në grupe. Gjeni foljet dhe thoni në ç'kohë janë. Kujtoi punimet në mal. Atëherë ne qemë të rinj. Pata një shok malësor. Ai ishte gjatë dhe i papërkulur. Shpesh thoshte: "Do të kemi fushë pjellore".
- 3 Lidhni foljet me përemrat e dhënë.

Unë	kisha	Ne	kishim
Ti	kishe	Ju	kishit
Ai, ajo	kishte	ata, ato	kishin

## Detyrë

1. Zgjidhni foljet që duhen dhe shkruani fjalitë në fletore.

Andi	ishin	me shokët në këndin sportiv.
	ishte	

Shkruani bashkësitë e foljeve **kam** e **jam** ne kohën e kryer të thjeshtë:

qeshë	pate	pata	qe	pati	qemë
qe qenë	patëm		patët		qetë

### Bisedë motivuese

Fundi vitit shkollor. Nxënësit porositen që t'i sjellin librezat e notave. Ata duhet ta dinë se librezat është një dokument që ruhet dhe u dëshmohet prindërve dhe miqve për suksesin e arritur në mësim dhe sjellje.

## GËZIMI I BARDHIT

Ishte ditë qershori. Bardhi plot gëzim e kureshtje u kthye nga shkolla. Atë ditë, ai kishte kryer klasën e dytë, fund e krye me pesa.

Erdhi në shtëpi. Sa e panë më të vegjlit, motrat dhe vëllezërit mbërthyen pas tij:

-Ta shohim librezën Bardh, librezën! -u dëgjuan ata, pothuaj që të gjithë njëzëri.

-Ja, urdhëroni!...Që të gjitha pesa!-u tha Bardhi.

-Pesaaa! Pesa edhe këtë vit- habitshëm e ngriti zërin gjyshi i tij, që rrinte këmbëkryq duke pirë çaj.

-Po gjysh, pesa, pesa ! - shpejtoi njëra nga motrat.

- Të tërat pesa gjysh!.. Të tërat! pohoi edhe vetë Bardhi.

- Mirë, djaloshi i gjyshit, mirë, për vete e ke!...

- Pse gjysh për vete, edhe për ju! - ia ktheu Bardhi.

- Poooo.. Edhe për ne, por më shumë për ty. Çfarë dotë mbjellësh, atë do ta korrësh.

Nëse kështu do të vazhdosh edhe në shkollimin e mëtejshëm, ardhmërinë do ta kesh të lehtë. Me fjalë të tjera, për ty nuk do të ketë dimër-përfundoi plaku.

*Nazmije Reka*

### Bisedim

- Si u kthye Bardhi nga shkolla?
- Pse shpejtuan motrat dhe vëllezërit pas Bardhit?
- Çka i tha gjyshi Bardhit?
- Pse gjyshi u shpreh: "Për ty nuk do të ketë dimër"?

### Fjalë e urtë

Mëso në rini  
të jesh i lumtur në pleqëri.

## Mësojmë për gjuhën

# SINONIMET DHE ANTONIMET

Lexojeni edhe një here këtë tekst:

Fjalët u ngjajnë rrobave tingëllore të sendeve. Sipas tyre i njohim ato, i veçojmë njëerën prej tjetrës, siç mund të dallojmë një mësues nga një ushtarë. Për shembull, kur dëgjojmë fjalën shkollë, kurrë nuk mendojmë për mollën. Por ndodh që një send nganjëherë të ketë disa palë rroba, ashtu si ne njerëzit. Merreni një shoqe tuajën. Ju e thirrni me emrin e vet. Nëna e quan bijë, vëllai i vogël e thërret motër. Të tjerët e quajnë çupë, gocë, vajzë ose çikë. Ju e keni shoqe. Por ajo është edhe nxënëse. E kjo është e njëjta, apo jo?

Në tekstin e mësipërm tek fjalët: çupë, gocë, vajzë, çikë. Shohim se janë fjalë që kanë kuptim të njëjtë .

Fjalët që kanë kuptim të njëjtë quhen sinonime, si. p. sh.: rrugë - udhë, filloj - nis, zë - kap, shikoj - shoh, vështroj - vë re etj.

Fjalët që kanë kuptim të kundërt quhen antonime, si p.sh: i bardh - i zi, lart - poshtë, natë - ditë, i dobishëm - i dëmshëm, i bukur - i shëmtuar etj.

## Detyrë

Shkruani në fletoret tuaja nga pesë sinonime dhe antonime.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit se a kanë vizituar ndonjë shfaqje në teatër ose ndonjë shfaqje në shkollë

# TEUTA NË TEATËR

Që në vegjëli Teuta kishte prirje për të recituar bukur, për të kënduar, për të imituar të tjerët... Në shfaqjet që organizoheshin në shkollë, ajo gjithnjë lozte role kryesore. Të gjithë i duartrokitnin dhe mburrreshin me të.

Njëherë erdhi në shkollë regjisore Meli. Asaj i pëlqeu shumë loja e Teutës, prandaj e ftoi të shkonte të luante role në shfaqjet për fëmijë në teatrin “Dodona”. Teuta sa nuk fluturoi nga gëzimi.

Shokët dhe shoqet e shkollës shkuan ta shikonin shfaqjen ku luante Teuta. Shumë prej tyre hynin për herë të parë në teatër. Atyre u bëri përshtypje çdo gjë: skena, skenografia, kostumet e akto­rëve, muzika etj., por mbi të gjitha loja e mrekullueshme e Teutës dhe e fëmijëve të tjerë aktorë.

## TË BISEDOJMË

Teuta luante role në shfaqjet e shkollës. Ajo i dinte prirjet e saj dhe punonte për t'i zhvilluar ato. Me punë të vazhdueshme ç bëri për vetë publikun e shkollës dhe kështu ra në sy edhe të regjisores. Kështu arriti të luante role edhe në teatër. Ky është një sukses që mund ta arrijnë pak fëmijë: vetëm më të talentuarit, më të vyeshtmit, ata që kanë besim në vetvete.

## TË MËSOJMË MË SHUMË

**Teatri** është ndërtesa në të cilën luhet në skenë një tekst letrar i shkruar për këtë qëllim (pjesë teatrale për fëmijë, dramë për të rritur etj.)

Në Kosovë teatri më i njohur është Teatri Kombëtar i Prishtinës.

**Skenë** quhet vendi në sallën e teatrit në të cilin aktorët shfaqin lojën e tyre. Ai që luan rol quhet **aktor**.

**Skenografia** është pjesë e skenës, që punohet nga druri, pëlhura etj. për të krijuar përfytyrimin e një mjedisi të caktuar (dhomë, oborr shtëpie, klasë, shpellë). Ai që e përgatit skenografinë quhet **skenograf**.

**Kostumet** (veshjet e mbretërve, lypsarëve, ushtarëve, fshatarëve, magjistarëve etj.) e aktorëve i përgatit **kostumografi**.

Muzikën për shfaqje e zgjedh ose e shkruan vetë **kompozitori**.

Një shfaqje është punë e shumë njerëzve me profesione të ndryshme, në krye të cilëve është **regjisori**, i cili i zgjedh të gjitha këta dhe i udhëzon çka duhet të bëjnë dhe si të veprojnë.

A e dini se...?

Në Angli më shumë njerëz shikojnë shfaqjet në teatër sesa ndeshjet e futbollit.

## Bisedim

- A ke parë ndonjë shfaqje teatrale?
- A dëshiron të luash ndonjë rol në ndonjë shfaqje?
- Cilët aktorë të teatrit i njeh?

## Detyrë

Shikoni shfaqje teatrale për fëmijë dhe bisedoni pastaj për përmbajtjen e shfaqjes (tekstin), lojën e aktorëve, veshjet e tyre, pamjen e skenës, muzikën etj. (Punë në grupe)





## GËZUAR

Salla dritë mbushur,  
thirrje plot gëzim,  
Viti i Ri, të pritëm  
e pa durim.

Jashtë fryn e bie,  
bora zbardhëllente  
brenda rrotull bredhit  
kënga jonë zinte.

Ndrite bredhi ynë  
lodra plot ngarkuar,  
na kënaqën synë  
yjet e praruar.

Eni, eni bashkë  
këngës le t'ia themi  
si sot të gëzuar  
Gjithmonë le të jemi!

### Fjalë dhe shprehje

- ziente                      • këndohej me shumë gjallëri  
e praruar                 • që ndriçon e shkëlqen

### Bisedim

- Cilës festë i është kushtuar kjo vjershë?
- Si do ta festoni Vitin e Ri?

## LEJLEKU

N' midis livadhit,  
n'kodër në lëmë,  
krenar lejleku  
qëndron në një këmbë.

Me sqep të mprehtë,  
zë peshq e mi-  
por edhe bretkosa,  
ha pa mërzi.

Për zogj të vet  
ka dashuri,  
prandaj lejlekun  
e do çdo fëmijë

Përmbi pullaz,  
përmbi pojatë,  
shihni lejlekun  
me qafë të gjatë.

E n'ja jazt' katundit  
përmbi mulli,  
përditë lejleku,  
del n' gjueti.

Këmb't si kamishi,  
sqepin si shpatë,  
porsi kavalli  
qafën e gjatë.

Mark Krasniqi

Të mësojmë më shumë  
Lexoje me vëmendje këtë strofe nga vjersha "Lejleku"

*Këmb 't si kamishi,  
sqepin si shpatë,  
porsi kavalli  
qafën e gjatë.*

Provo të gjesh çka kanë të përbashkët e fjalët me shkronja të zeza.  
Në vargjet e nënvizuara pjesët e trapit të lejlekut janë krahasuar me sende tjera të ngjashme.  
Kjo mënyrë e përshkrimit përdoret shpesh në letërsi dhe quhet **krahasim**

### Detyrë

Shkruaji pesë fjali me nga një krahasim, sipas këtij shembulli: *I kishte faqet të kuqe si molla*



## Bisedë motivuese

Bisedoni për festat e ndryshme. Si festohen ato?

### KORÇA

O vëllezër Shqipëtarë,  
Gëzohi se erth kjo ditë  
Kaq' e mir' e kaq e mbar  
Na sjell mirësitë

Kjo është dit' e rezë  
Që bije vëllazërinë,  
E dëbon jetën e zezë  
Dhe ndarjen e marrëzinë

Lumja ti, moj Korç' o lule  
Q'i le pas shoqet e tua,  
Si trimi në ball' u sule,  
Ta paçim për jetë hua!

*Naim Frashëri*



### Fjalë dhe shprehje

mirësitë	• gjithë të miral
e rezë	• e re
dëbon	• largon, përzë
u sule	• u hodhe
të paçim hua	• të paçim borxh

### Bisedim

Për cilën ditë duhet të gëzoheshin shqiptarët?  
Çfarë ishte dita e hapjes së shkollës shqipe?  
Pse ia ka lakmi poeti Korçës?

### T'i zgjerojmë njohuritë

7 Marsi është Dita e Mësuesit. Në këtë ditë të vitit 1887 u hap shkolla e parë në Korçë. Atëbotë shqiptarët ishin ende nën robëri. Gjuha shqipe ishte e ndaluar. Fëmijët shqiptarë detyroheshin të mësonin turqisht ose greqisht. Naim Frashëri këtë poezi ia kushtoi pikërisht kësaj shkolle. Mësues të parë kanë qenë Pandeli Sotiri, Petro Nino Luarsi, Naçi Nuçi etj.

Pas kësaj shkolle u hapën edhe shumë shkolla të tjera, si në: Dibër, Ohër, Shkup, Kumanovë e gjetiu.



## Bisedë motivuese

Tregoni se ç' kujtime keni nga gjyshet tuaja. Bisedoni për ato.

### BALADA E BURRAVE

Kam pasur një gjyshe  
mbi të gjitha gjyshet,  
kur ajo tregonte,  
heshtin dallëndyshet.

Kur fliste ajo,  
mbanin vesh edhe gurët,  
thaheshin moçalet,  
lulëzonin drurët...

Moj e mira gjyshe,  
kur të sjell në mend,  
më kujton një re,  
më kujton një shkëmb.

Kur isha i vogël,  
shpesh të kam pyetur:  
-Këta shkëmbinjtë ç'janë,  
pse rrinë e heshtur?

Ata mbi supe  
mbajnë këtë dhe  
ku ka mbirë ulliri,  
ku jetojmë ne.

*O. Grillo*

### Fjalë dhe shprehje

mbanin vesh edhe gurët  
mbi supe

- dëgjonin edhe gurët
- mbi krahë

### Bisedim

Si i këndon gjyshes poeti?  
Cilat janë mbresat e djalit nga biseda?  
Ç'kupton i nga strofa e dytë. Nxirreni idenë duke e komentuar strofën.

### Detyra

1. Gjeni ndonjë vjershë për gjyshin apo gjyshen.

## Bisedë motivuese

Bisedoni se kush di në klasë përralla. Le të tregojë dikush ndonjë përrallë

# I ATI, I BIRI DHE GOMARI

Një atë shkonte një ditë bashkë me të birin e tij në treg me një gomar të ri për dore. Asnjëri s'kishte hipur në të. Njerëzit e tjerë, që e panë duke ecur në këmbë e me gomar të pan-garkuar, i thanë njeri-tjetrit:

-Shihni ata dy që janë fare pa mend; kanë gomarin e nuk u hipin, lodhen e grisin këpucët më kot; ah, të humbur që janë!

I ati u mërzi shumë nga këto fjalë dhe i tha të birit:

-Biri im, bota po flet për ne se po ecim në këmbë; hipi, pra, ti gomarit.

Djali e dëgjoi menjëherë hipi, por sapo bënë vetëm pak hapa kur erdhën ca të tjerë, të cilët, duke parë djalin mbi gomar, i thanë:

-Zbrit, o djalë i paturp e i pander! Ti je i ri e i shëndoshë e shkon kaluar e yt atë plak e i sëmure të vjen prapa si shërbëtor. Si nuk ke dashuri, si nuk të dhemb fare zemra për të?

Djali u turpërua nga këto të shara, zbriti prej gomarit, e vuri t'anë mbi të, por pas ca kohe arritën të tjerë udhëtarë, që zunë t'u thoshin kështu:

-O punë e bukur! Ai që ka eshtrat e forcuar nga mundimi është mësuar të ec, ka hip mbi gomar e ka lënë djalin e tij të vogël të shkojë në këmbë e të lodhet. Sa keq!

-Bota nuk është as tani e kënaqur-i tha atëherë i ati të birit,- hip pra, edhe ti e të jemi të dy bashkë mbi gomar.

E kështu bënë. Po as kjo punë nuk u doli mirë; udhëtarët e qeshën përsëri, e këtë herë edhe më fort, duke u thënë se ish vepër e pashpirt dhe e turpshme ta mundonin ashtu një kafshë të mjerë.

Të zbrisim të dy e të marrim gomarin mbi shpinë, se s'kemi ç'të bëmë tjetër.

E kështu me të vërtetë bënë, por më vonë, duke e parë se bota përsëri i talli, e kuptuan se ishte marrëzi e madhe t'u vihej veshi fjalëve të saj. Kështu herën tjetër zunë mend, e udhën që u mbeti e bënë si u pëlqeu më mirë

*Luigj Gurakuqi*

## Fjalë dhe shprehje

të vemi

• të shkojmë

të prishur mendsh

• të marrë, të pamend

zunë mend

• mblodhën mendjen, u bënë të mençur

t'anë

• babain

bota

• këtu, njerëzit

## Bisedim

- Si shkonin në fdlim atë e bir dhe ç' thanë të tjerët për ta?
- Ç' thanë kur e panë djalin mbi gomar?
- Po kur e panë t'atin mbi gomar?
- Ç' thanë kur i panë at e bir hipur mbi gomar?
- Përse e morën gomarin në shpinë?
- Ç'mësime nxorën babë e bir nga ky udhëtim?

## Detyra

Lexojeni bukur tregimin sipas roleve

## E BIJA E HËNËS DHE E DIELLIT

Ishte një nënë. Kishte një djalë. Të vetëm e kishte.

E donte me përgjëratë.

Djali donte të dilte për gjah.

Nëna e porositi

“Bir, o bir! Gjithë maleve të gjuash, veç në mal të kuçedrës mos gjuaj. Se kuçedra është shumë keqe, bir. Të ha, të përpin. Atje kanë shkuar shumë trima e nuk janë kthyer prapë”.

Djali nuk e dëgjoi nënën, po dëgjoi vashën e zemrës

Vasha i tha:

“Trim, në më do mua, në asnjë mal të mos gjuash, vetëm në mal të kuçedrës të gjuash!”

Trimi e donte shumë vashën e bukur dhe nuk ia shkelte kurrë ijalën. Pra, u ngrit e shkoi të gjuaj në mal të kuçedrës. Sa u ngjit lart, zuri të lëkundet dheu me gjithë gurë e drurë.

Djalit i doli përpara kuçedra e madhe me shtatë krerë e shatë brirë, me sy, si pishtar të ndezur, me gojën si një shpellë, me flatra në kurriz, si krahët e lakuriqit të natës, po shumë më të mëdha. Nxirrte tym e flakë të verdhë nga goja. Kjo flakë digjte e përvëlonte barin, lulet e shkurret. Përpoqi tri herë bishtin dhe u bë tërmet i madh. Djali nuk u tremb: vuri shigjetën në hark. Shigjeta u nis, fërshëlleu, po nuk i bëri asgjë kuçedrës. I ra me shtizë, po as shtiza nuk i bëri gjë. Nxori shpatën, po kuçedra lëshoi një grahamë kaq të fortë, sa djalit i ra shpata nga dora.

Kështu, trimi mbeti përballë kuçedrës pa shigjeta, pa shtizë, e pa shpatë.

Kuçedra qeshi me shatë gojët, iu afrua, e përcëlloi me flakë e i tha:

-Tani unë do të të ha, o djalë, se ti shkele malin tim. Nuk ke dëgjuar se ai që shkel këtë mal, nuk mbetet i gjallë. Bëhu gati!

Moj kuçedër strërkuçedër, unë e shoh se ti do të hash. Me të vërtetë qenke shumë e fortë. Të lutem vetëm një gjë: më lër të shkoj gjer në shtëpi që t'i kërkoj nënës uratën e vdekjes. Pastaj do të kthehem këtu që të më hash.

-Ç 'do të më japësh ti mua që të të lë të shkosh?

-Do të jap besën time.

-Mirë, nëma besën dhe shko.

Djali i dha besën kuçedrës, zbriti malin, shkoi drejt në shtëpi e i tha nënës:

Zonja nënë, mua më zuri kuçedra në malin e saj tek po gjuaja e tani do të më hajë. Unë i dhashë besën se do të kthehem e ajo më lëshoi...Tani falma uratën e vdekjes se do të shkoj të më hajë.



Ai i puthi dorën, ajo i fali uratën, u vesh me të zeza, u mbyll në shtëpi...

Djali shkoi te vasha e zemrës e i tha:

-Të falem, moj e bukura ime! Kam ardhur të të lë lamtumirën, se unë do të shkoj e nuk do të kthehem më. Do të më hajë kuçedra, se më zuri tek gjuaja në malin e saj. I dhashë besën se do të kthehem prapë të më hajë. Pra, mbeç gëzuar, moj e bukur,- Prit, djalë se do të vij edhe unë në mal me ty.

-Djali u vrenjt.

-Mos eja, moj e bukura ime, se atje tunden gurët e drurët, kuçedra është shumë e keqe, të përvëlton, të ha, të përpin.

-Unë nuk vij, po të rrish edhe ti me mua përngaherë.

-Nuk mund, moj vashë, i kam dhënë besën kuçedrës e nuk shkel dot...Më mirë të vdes se sa besëshkelur.

E bukura qeshi e i tha:

-Do të vij me ty.

\*

\*

\*

Vasha i hipi një kali të bardhë, trimi i hipi një kali të zi e ia morën përpjetë malit të kuçedrës.

E bukura e vuri re se ai diç bluante në mendje dhe e pyeti:

-Ç 'mendon ti, o trim?

Ai tha ç' mendonte:

-Të kisha pasur, moj e bukur tri jetë, do t'ia falja të tria kuçedrës, që ti të shpëtoje e të ktheheshe në shtëpi e të rroje e lumtur.

Ajo e vështroi tërë gaz.

-Edhe pa ty?

-Qoftë edhe pa mua...

-Kaq shumë më do?

-Shumë...

Ndërkaq bubulloi tërë mali, u tundën gurët e drurët. Doli kuçedra me shtatë krerë e ia mori këngës:

"Lumja unë e lumja! Kisha një m' u bënë dy! Po më vjen një vashëz e njomë. Do ta ha, do ta përpi!"

Vasha e bardhë qeshi e ia ktheu:

-Mjerë ti e mjera, moj kuçedër. Kishe një e s' ke asnjë. Dhe ti vetë do të hysh në fund të dheut, se ky mal është i njerëzve e do të jetë i njerëzve.

Vasha e trimi iu afruan kuçedrës. Ajo zuri të mprihte dhëmbët e të lëshojë zjarr nga goja. Po me një të shikuar, vasha e mbërtheu në vend. Kuçedra u tremb, u mundua të prapset.

-Cila je ti, moj vajzë e bardhë, që më kall të ngjethura në shtat? Ç'është kjo dritë që të farfurinë në fytyrë? Ç'është ky zjarr që po më djeg kështu?

-Jam bija e hënës dhe e diellit, jam pika e qiejve që bie kudo, në male e fusha, mbi kryet e të ligjeve, për të mirën e të mirave, për shpëtimin e njerëzve.

-Ç' e ke ti këtë trim, moj vashë e bardhë?

-E kam shoqin e jetëve.

-Vashë mbi vashazat e dheut,- tha kuçedra e gëzuar.

Trashëgofsh të ritë tënd me trimin e zgjedhur. Paski qenë të dy të besës e më mundët.

-Po ti, moj kuçedër e stërkuçedër, ç' do të besh tani?- e pyeti e bija e hënës dhe diellit, që mbante në dorë një shigjetë drite: pikën e qiellit.

-Meqë ti më munde, unë s' kam më vend në këtë botë. Do të hyj në fund të dheut e nuk do të dal më kurrë.

Dhe kuçedra u zhduk e nuk doli më, ndofta u dogj e u bë hi, ndofta u fut në fund të dheut.

Ata të dy, vasha e bardhë e trimi i besës rrojtën e trashëguan jetë pas jete. Edhe në mal të kuçedrës gjahtarët zunë të venë për gjah si në të gjithë malet e tjera. Atje zunë të kumbojnë këmborë kopesh dhe sëpata druvarësh, sepse jeta e mundi vdekjen.

*Mitrush Kuteli*

*(“Tregime të moçme shqiptare”)*

## Fjalë dhe shprehje

përgjërata	• dashuri e thellë dhe mall i pashuar
hurë e drurë	• këtu: gjithçka
stërkuçedër	• kuçedër e përbindshme
jap besën	• jap fjalën
jap uratën	• këtu: jap fjalën e fundit
ngazëllim	• gëzim i thellë
besëshkelur	• ai që s' mban fjalën e dhënë
farfurij	• shndritë, shkëlqej

## Ritregojeni përmbajtjen me fjalët tuaja

### Të dini më tepër.

Tregimin e ka shkruar Mitmsh Kuteli. Ai njihet si mjeshër i shquar i prozës (tregime) shqipe. Emri i vërtetë i tij është Dhimitër Pasko (1907-1966)

## FËMIJA I MREKULLUESHËM I SHEKULLIT

Volfang Moxarti ka lindur në qytetin Salzburg, që tani i përket Austrisë. Që kur ishte fare i vogël, u dallua për talentin e tij.

Kur lodhej nga mësimi, vraponte pranë sëmës dhe i lutej t'i tregonte ndonjë përrallë. Nëna e qeshur dhe e dashur dinte plot përralla të bukura, por ato që i pëlqenin më shumë djalit, ishin: “Mbretëresha e natës”, dhe “Flauti magjik” etj. Moxarti do t'i kujton-te gjithë jetën dhe do t'u thurte muzikën më të bukur.

Kur ishte tre vjeç, Moxarti kishte kënaqësi të luante në tastierë. Çdo tingull kishte një kuptim për të: njeriu i dukej sikur e përkëdhelte, tjetri sikur e qortonte. Stonimet e bënë të dridhej. Kur u bë katër vjeç, vogëlushi Moxart lexonte notat.

Ky djalë i jashtëzakonshëm ishte shumë i dashur. Të gjithë ata që i afroreshin, i pyeste: “A më do shumë?”, dhe kur ndonjëri i thoshte “Jo”, ai fillonte të qante.

Për muzikën që shkroi në fëmijëri, ai u quajt “fëmija i mrekullueshëm i shekullit”. Moxarti vdiq në moshën 37- vjeçare.

### Fjalë dhe shprehje

- |          |  |                        |
|----------|--|------------------------|
| tastierë | • vendi ku u bie notave ose ku janë të vendosura | shkronjat në kompjuter |
| notë     | • notat në muzikë shkruhen me shenja             |                        |
| stonon   | • nuk këndon mirë, nuk shkon sipas notave        |                        |



## Bisedim

- Kush qe Moxarti?
- Ku ka lindur ai?
- Çfarë i pëlqente Moxartit kur ishte i vogël?
- Çfarë bëri kur ishte tre vjeç?
- Pse u quajt fëmijë i jashtëzakonshëm? Përse u quajt “fëmija i mrekullueshëm i shekullit”?

## Të lexojmë bukur

Duke iu përmbajtur shenjave të pikësimit (:, “), lexojeni pjesën ku Moxarti pyetet se ç'mendojnë të tjerët për të.

## Ta ritregojmë pjesën sipas këtyre pikave

1. Vendlindja e Moxartit.
2. Moxarti dhe nëna.
3. Moxarti dhe muzika.
4. Fama e Moxartit.

- Bisedojmë së bashku
- A keni dëgjuar të flitet për Moxartin?
- Pyeteni mësuesen për Moxartin dhe plotësojeni këtë pasqyrë me + ose - sipas përkatësisë

MOXARTI Ishte	<b>i talentuar</b>
	<b>kompozitor</b>
	<b>i zellshëm</b>
	<b>këngëtar</b>
	<b>valltar</b>
	<b>punëtor</b>

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit përse bëhet luftë?



## LEGJENDA PËR TRE VËLLEZËRIT

Kjo tash është vetëm legjendë. Ndoshta dikur, para mijëra vjetësh, ka qenë e vërtetë. Në një kasolle të mbuluar me fletë kallmi, jetonte një nënë. Ajokishte tre djem të vegjël. Mezi i mbante. Kishte qenë e lumtur sa e kishite të shoqin, por një ditë ai shkoi të gjuante në pyllin e afërt e nuk u kthye më.

Rrobat e djemve të saj nisën të vjetroheshin. Nëna i ngushëllonte duke u thënë:

“Një ditë do të hipi në kodrinë, do të mbërrij ylberin dhe me penjtë e

flokëve të mi do t’ju qep çdonjërit prej jush rrobat më të bukura në botë...”

Tre djemtë e vegjël shpresonin e pritnin. Rrobat vjetroheshin gjithnjë.

Nëna ende nuk ua priste rrobat e premtuara.

Ushqeheshin vetëm me bukë thekre. Nëna i ngushëllonte duke u thënë:

“Një ditë do ta mbys një dre. Prej mishit të tij do të bëjë gjellët më të shijshme për ju...”

Tre djemtë prapë shpresonin dhe pritnin.

Një ditë nuk pritën më: morën shigjetat, harqet dhe shkuan në pyll.

Në mbrëmje u kthyen të lumtur: kishin vrarë një drerë të egër e të madh. Prej mishit të tij bënë gjellë të shijshme e nga lëkura qepën rroba të reja.

Në mbrëmje pyetën nënën e tyre për babanë.

Ajo tregoi ngadalë, me zë të qetë, se kishte shkuar një ditë në pyll, kura ata kishin qenë të vegjël, dhe nuk ishte kthyer më.

-O nënë, ne duhet ta gjejmë babanë tonë...”, -thanë tre djemtë njëzëri.

“Ne nuk do të kthehemi pa ditur ç’ka ndodhur me babanë tonë”!

Të nesërmen u nisën sapo zbardhi dita.

Vëllai i parë u nis andej nga lindja e diellit.

Vëllai i dytë nga jugu.

Vëllai i tretë u nis nga veriu.

Udhëtuan për një kohë të gjatë. Kishin vendosur të mos ktheheshin pa marrë vesh diçka për babanë e tyre.

Vëllai i parë kaloi shumë fusha e male. Ecte çdo ditë andej nga lindte dielli. Arriti në një shkretinë. Pluhuri i verdhë i mbështillej në trup, në fytyrë. Arriti në një oazë. Lau sytë, por pa se ngjyra e lëkurës nuk i ndryshoi. I mbeti e verdhë, ashtu siç ishte ngjyra e shkretëtirës.

Vëllai i dytë udhëtoi pa u ndalur. Kaloi edhe ai shumë fusha e male. Sa më shumë



shkonte kah jugu, aq më tepër i përcëllonte dielli me ato rrezet e zjarrta. Lëkura e tij ishte nxirë krejtësisht, ishte lodhur, por nuk ndalej. Kur arriti te një krua, lau sytë, por pa se ngjyra nuk i ndërroi më. I mbeti e nxirë.

Vëllai i tretë udhëtoi pa u ndalur. Kaloi edhe ai shumë fusha e male. Sa më shumë udhëtonte, behej gjithnjë më ftohtë. Por as ai nuk u ndal. Ecte gjithnjë përpara, duke dëshiruar ta gjente babanë e humbur.

Kështu tre vëllezërit udhëtuan, udhëtuan dhe nuk e gjeten babanë e tyre. Ditën e shtatëdhjeteshtatë të udhëtimit të tyre ata takuan nga një bukuroshe. U martuan me to dhe kështu harruan të ktheheshin në kasollen e vjetër.

Vëllait të parë i lindën shumë fëmijë me ngjyrë të verdhë të lëkurës.

Vëllait të dytë me ngjyrë të zezë.

Vëllait të tretë me ngjyrë të bardhë.

Pas shumë kohësh të tre u takuan në një fushë të madhe. Secili ishte udhëheqës i një ushtrie. Ata nuk e njohën njëri-tjetrin dhe nisën të luftonin kundër njëri - tjetrit.

Ajo luftë vazhdon edhe sot, rrëfen legjenda dhe do të vazhdojë derisa njerëzit e bardhë, të zinj dhe të verdhë do të kujtojnë se janë vëllezër.

*Ymer Elshani*

### Fjalë dhe shprehje

kallam	• bimë që rritet nëpër moçalishte
e ngushëllonte	• i fliste fjalë të ëmbla për t'ia lehtësuar dëshpërimin
oazë	• vend me ujë dhe bimë në mes të shkretëtirës
përcëllonte	• digjte

### Bisedim

- Çfarë u premtonte nëna fëmijëve? Përse ajo nuk i mbante dot premtimet?
- Përse secili nga vëllezërit mori rrugë tjetër?
- Ç'ngjyrë morën dhe pse?
- A u kthyen prapë në kasollën e tyre?
- Çfarë fëmijësh i lindën secilit prej tyre?
- Ku u takuan ata përsëri dhe ku?
- Kur do të marrin fund luftërat ndërmjet njerëzve?

### Të dimë me tepër

Nëpërmjet të këtij tregimi autori është përpjekur të na e japë historinë e njerëzimit. Mirëpo, luftërat në botë nuk bëhen vetëm për shkak të ngjyrës së ndryshme të njerëzve, vetëm për shkaqe racore. Bisedoni me të vjetrit për shkaqet e tjera të luftërave.

### Detyrë

Tregojeni përmbajtjen e kësaj legjende me fjalët tuaja.

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit mbi humanizmin. Si shprehet humanizmi në shkollën tuaj

# GJARPRI, KUTIA DHE SYLIGU

(Sipas një përralle popullore)

Një djalë i varfër e zemërmirë gjeti një gjarpër gati të ngrirë. E mori dhe çoi në kasollen e tij.

Kur gjarpri edhe në vete, i foli djalit:

-Të mirën që pabëre, dua të shpërblej. Do të shkojmë te babai im gjarpër. Do t'i thuash: "Ma jep kutinë." Po ta tundësh, ajo t'i plotëson dëshirat.

Djali shkoi te babai i gjarprit dhe i kërkoi kutinë.

Gjarpri në fillim ngurroi, por ia dha djalit kutinë.

Sa po arriti te kasollja, e tundi kutinë.

Kasollja u bë pallat, kurse prindërit e tij u veshën me rroba të reja. Ai u tregoi prindërve për fuqinë magjike të kutisë.

Kur i ligu e mori vesh, u mbush inat:

-Leckamani bëhet i pasur! Kurrë!

Ai zuri një mi dhe tha:

-Mi, o mi, do ma selish kutinë magjike?

-Do të ta sjell, - i tha miu.

Kur ra nata, miu u përvodh në dhomë të djalit. Atje gjeti kutinë dhe ia solli syligut.

Pallati u bë sërish kasolle dhe rrobat e bukura u kthyen në lecka.

Gjarpri i vogël dëgjoji për ndodhinë. E zuri miun dhe e hëngri.

Pastaj shkoi te Syligu dhe ia rrëmben kutinë. Syligu plasi nga inati.

Djali u bë sërish me kutinë magjike.



*Xhavit Bushati*

## Fjalë dhe shprehje

zemërmirë	• që bën mirë
kasolle	• shtëpi e vogël
magjike	• që bën gjera të pamundshme
pallati	• shtëpi e madhe dhe e bukur, zakonisht e mbretit
Syligu	• njeri me sy të keq, që bënë keq

## Bisedim

Në këtë përrallë flitet për sjelljet e njerëzve.

1. Çfarë sjellje bëri djali i mirë?
2. Si ia ktheu gjarpri të mirën?
3. Çka bëri kutia?
4. Kush u bë xheloz?
5. Kush ia mori kutinë djalit?
6. Çka bënte kutia e gjarprit?
7. Kush ia ktheu djalit kutinë?

## Detyrë

Ritregojë përrallën e me fjalët e tua

## Fjalë e urtë

Bëje të mirën dhe hidhe në det!

## FJALË TË URTA DHE GJËEGJËZA POPULLORE

### Fjalë të urta

1. Punën e sotme mos e lë për nesër.
2. Mos i shiko gunën, por shikoi punën.

### Populli

3. Trupi shëndoshet me të punuar,  
Mendja ndriçohet me të mësuar

### Naim Frashëri

4. Sa të rrosh do të mësosh.

### Populli

### *Gjëgjëza e kashelasha*

1. I ke dhjetë,  
hiq dhjetë  
mbeten dhjetë  
Çështë? \_\_\_\_\_
2. Kur i lidh ikin  
Kur i zgjidh ikin.  
Çështë? \_\_\_\_\_
3. Ara e bardhë,  
fara e zezë  
e mbjell me dorë  
e korr me gojë  
Çështë? \_\_\_\_\_

## Të lexojmë bukur

- Lexoni fjalët e urta ngadalë dhe me kuptim.
- Lexoni gjëgjëzat, duke e menduar përgjigjen.

## Bisedim

E keni lënë ndonjëherë punën e sotme për nesër?

Po të nesërmen a e keni mbaruar?

Si është më mirë?

Një njeri mund t'ju pëlqejë nga pamja e jashtme, por ai nuk ka sjellje të mirë. Ç'mendoni për këtë? Në rastin e kundërt?

Ç'ndjeni kur mësoni mirë? Po kur lexoni libra?

## Ritregim i përmbajtjes

- Duke u mbështetur në domethënien e fjalëve të urta, tregoni ndonjë shembull që lidhet me to.
- Shpjegoni me fjalët e tuaja përse dhatë përgjigje të tilla për gjëgjëzat?

## Fjalë e urtë

- Mësoni fjalë të tjera të urta. Pesë prej tyre i shkruani në fletore.
- Në fund të secilës shënoni nga kush e keni mësuar.
- Mësoni përmendsh fjalët e urta që gjenden në tekst.
- Shkruani tri gjëgjëza që i dini e që ju pëlqejnë më shumë.

## Mësojmë

*Fjalët e urta popullore tregojnë për urtësinë e popullit. Gjëgjëzat popullore kërkojnë zgjuarsinë t'u zgjidhur. Ato quhen edhe kashelashë. Kashelashat kanë gjuhë figurative, humor dhe karakter të qartë kombëtar*

## Bisedë motivuese

Bisedoni me nxënësit si i gëzohen borës, si luajnë ata me borën.



## DIMRI

Babadimri dhe Gjyshebora qëndronin ulur në majën më të lartë të malit dhe shikonin birin e tyre Veriun, që i lëvizte degët e drunjtë. E degët, nga fryma e fortë e tij, lakoheshin për toke.

Shiko Gjyshe, -1 thoshte plaku mjekërbardhë Gjysheborës. Fusha është zbardhur dhe ka mbetur e shkretë. E atje, në mal, sikur gjithçka është e ngurosur. Lumenjtë janë ngrirë, akulli i ka kapluar. Askund zogu të këndojë, asnjë gjurmë me kafshëve. Gjithçka e gjall frikohet dhe fshehet nga fërfëlliza e Veriut tonë.

Bëj diçka.

Gjyshebora sikur e priste këtë. Menjëherë i hapi sëndukët e ngrirë dhe prej tyre nxori vesh- jen e saj të bardhë, por të butë. E përhap i mbi drunj, ara, livadhe, lugina, brigje dhe aty për aty i mbuloi me pëlhurën e ngrohtë.

Toka e ngrirë dhe e fortë u zbut. U ngrohën bimët e ndryshme. Ngrica e tejdukshme u zhduk.

U ngjallën luginat. Fëmijët filluan të vrapojnë. Kush me saja e kush me ski. Bënin dordolecë. Këndonin...

Tash dhe lumi nuk dukej si më parë. Edhe pranë tij u afruan fëmijët. Rrëshqitnin. Kaloni prej njërit breg në tjetrin.

E në qytet, nëpër parqe e para ndërtesave, dordolecët paraqiteshin si kërpudha pas shiu. Kurse nënat që qëndronin në dritare, të brengosura bërtitnin:

- Agim, mos e nxjerr pallton. Do të ftohesh!
- Vjosa, merri dorëzat dhe shallin!
- Enis, mos fut borë në gojë. Ruaje fytin!
- Ramë, eja t'i ndërrosh çorapet. Të lagura janë!

As në ato çaste të lumtura fëmijët nuk harruan miqtë e vet me flatra - zogjtë. U bënë çerdhe në ballkone, kopshte, pemë dhe oborre. Edhe fëmijët e çerdhes "Lulja" bënë shtëpizë të vogël.

Nuk i harruan as gjallesat e kopshtit zoologjik. Rregullisht i vizitonin dhe u çonin ushqim.

Daja Ujk dhe Tezja Dhelpër pritnin të fushin diçka në barkun e tyre. Për ta në mal dhe livadhe kishte pak e më pak ushqim. E dini se ku mund të gjejnë. Por atje i priste rojtari syçelë, Laroshi. Pamje e bukur është kur ti shikosh oxhaqet se si tymojnë deri në orët e vona të natës. Aq më shumë mbi pullazet e bardha. Dhe deri sa jashtë hëna ndriçon natën dimërore, fëmijët pranë koftorëve të ngrohtë dëgjojnë përrallat e gjysërve dhe gjysheve...

### Fjalë dhe shprehje

fërfelliza	• kur qimton bora me erë
të brengosura	• të mërzitura
të birin e tyre Veriun	• erën e ftohtë të dimrit
veshjen e saj të bardhë	• borën

### Bisedim

Kush e shikonte birin e tyre Veriun?  
Si dukej natyra para se të binte borë?  
Ç'kërkonin nënat nga fëmijët e tyre?  
Çfarë pamje kishte nata?

### Plani

Natyra  
Gëzimi i fëmijëve  
Nënat në dritare D  
Dordolecët para ndërtesave

### Detyrë

Bëjeni një hartim të shkurtër me titull "Bora e parë"!

## Bisedë motivuese

Tregoni ndonjë përrallë që e dini.

# MBRETI KËRKON MENÇURI

Një herë, një mbret kishte dëgjuar se në mbretërinë e tij jetonte një fshatar i mençur. Mbreti, i shoqëruar nga suita e tij u nis te fshatari.

- Pse je kaq i mençur?
- Mençurinë e kam gjetur! - ja ktheu fshatari.
- A mund të gjendet mençuria?
- i tha mbreti.
- Po! Mbret i nderuar!
- Më trego dhe mua si e gjetë?



Eh, kjo është punë e lehtë! Merrni një lopatë dhe ejani pas meje!

Mbreti u gëzua shumë. Ecte e mendonte me vete: “ Me të vërtetë mbret jam, por dituri s’kam. Fshatarët më quajnë të trashë nga mendja, e po e gjeta mençurinë do të mbush kokën time mirë e mirë dhe dy arka që t’i ruaj për birin tim, kur ai të bëhet burrë!”

Ecën e ecën gjersa arritën në një tokë ranore.

Fshatari zhveshi rrobat dhe, si i përveshi mëngët, i tha mbretit:

- Hiq rrobat e mëdha dhe eja të fillojmë nga puna!

Mbreti ndiqte këshillat e fshatarit. Punonte dhe djersa rridhte çurk, por dituri nuk po gjente. U lodh dhe u zemërua me fshatarin.

- Ku e ke mençurinë, more fshatar?
- O mbret, pritni e mos nxitoni! Gërmoni!

Këtë vit hapim këtë tokë, në pranverën që vjen do të mbjellim mençurinë dhe në verë do ta korrim! - tha fshatari e vazhdonte të punonte.

- Kjo mençuri që the, mos është drithi?
- Po, ai është! Po të mos kishte në pallat drithëra, që prodhohen me gjakun e djersën tonë, si do të jetonit u, o mbret, që kërkoni mençuri!



## Fjalë dhe shprehje

- suita • njerëz që e shoqëronin mbretin  
çurk • pa ndërprerë

## Bisedim

- Ç'kërkonte mbreti?
- Ku shkuan ta kërkonin mençurinë?
- Ç'mendonte mbreti gjatë rrugës?
- Pse u zemërua mbreti ndaj fshatarit?
- Cila ishte mençuria për mbretin?

## Plani për ritregim


Përgjigja e fshatarit  
Hapja e tokës  
Zemërimi i mbretit  
Gjetja e mençurisë

## Detyrë

1. Tregoni në klasë ndonjë përrallë që e keni dëgjuar nga gjyshi ose gjyshja mbi mbretërinë!
2. Nxirre kuptimin e kësaj përralle dhe veçoje porosinë e saj!

## Bisedë motivuese

Bisedoni rreth pastërtisë: Çka janë ato mikrobe?; Si zhduken dhe me çka?; A dallohen me sy?; Ato shihen me një mjet që quhet mikroskop. Vizitoni kabinetin e biologjisë



## FITORJA E EDLIRËS (tregim fantasiko-shkencor)

Atë ditë komandanti i mikrobeve dukej shumë i inatosur dhe s'pushonte së thëni me zë të lartë:

-Ah, kjo skuadra e higjienës sanitare! Paska qenë armike e betuar e ushtrisë sonë të mikrobeve. Edhe Ceni pisanjosin, që shpresonim aq shumë ta së- murim, e shpëtoi... Tani Ceni ka filluar ta mbaj pastër trupin. Sakeq! Kas-

nec!...

-Urdhëroni, zotëri !-u përgjigj menjëherë një mikrob barkalec.

-Të lajmërohen zbuluesit!

-Si urdhëroni zotëri!...

Pas pak, tre zbuluesit qëndronin të heshtur e hijerëndë para komandantit të tyre.

-Dëgjoni bijtë e mi! Do të shkoni në klasë[n e katërt. Do të kontrolloni një për një nxënësit. Në qoftë se do të zbuloni ndonjë femijë pis, më lajmëroni menjëherë.

-Si urdhëroni!

Tre zbuluesit u larguan me një frymë.

Kontrolluam secili nga një radhë e pastaj shkuam kokulur e të pikëlluar në qoshen e korridorit, atje ku kishte ngritur çadrat ushtria e mikrobeve.

-E bijtë e mi, ç' lajme më sillni?- pyeti komandanti i mikrobeve.

-Lajme të këqia. Të gjithë nxënësit kishin ardhur të rregullt, me duar të lara, fytyrë e dhëmbë të pastër, me shami hundësh e me këpucë të lyera...

-Po thonj të paprerë a kishte ndonjëri? Oh, sa do të gëzohesha!

-Jo s' kishin!- thanë tre zbuluesit.

-Duhet sulmuar pa humbur kohë Edlira, komandantja e skuadrës së higjienës. Po të

sëmurim atë, nxënësit do të mbeten pa kujdestare pastërtie dhe pastaj do të fitojmë!- tha komandanti.

-Edhe po sëmuret Edlira, nxënësit do të vijnë të pastër.

A tyre ua është bërë zakon të vijnë gjithnjë kështu,- tha me gjysmë zëri dhe e druajtur një nga zbuluesit.

-Hesht!-thirri si tërbuar komandanti,-Kasneç!

-Urdhëroni, zotëri!

-Lajmëroni shtabin të mblidhen menjëherë!

\*

\*

\*

Edlira fshiu me kujdes klasën me fshesë të njomure, megjithatë, një pjesë e vogël e grimcave të pluhurit filluan të vërtiteshin nëpër klasë si aeroplanë. Pas pak, miliona mikrobe, ashtu si parashutistët, filluan të binin mbi Edlirën dhe zunë vendet që pati caktuar komandanti.

Mikrobeve që kishin zënë vendin në duar, s'u pritej që Edlira të fillonte të hante.

Por, para se të hante, Edlira i lau mirë e mirë duart me sapun e ujë të bollshëm, të rrjedhshëm. Me ulërima të përvajshme miliona mikrobe u shkëputën nga duart dhe gjysmë të mbytura ranë në tubin e errët e të thellë të lajtores.

Mikrobet kishin zënë vend në fytyrë, filluan të dridheshin nga ato që u panë sytë.

=Boboo, sa frikë!. Por sikur të kujdesej ta lajë fytyrën? Të shkretat mikrobe...Më kot shpresuam, sepse Edlira lau me kujdes edhe fytyrën dhe ushtria e mikrobeve pësoi prapë një humbje të madhe.

Komandanti i mikrobeve, duke u ushqyer me një thërrmimë buke të mbetur midis dhëmbëve, arriti të shumëzonte ushtrinë e tij gjerë dy milion ushtarë...

Sikur Edlira të kishte pasur edhe një dhëmbë të sëmure, do të futeshin brenda çarës së dhëmbit e do të shpëtonin .Por, Edlira i kishte mbajtur me kujdes dhëmbët. Kur ajo mori në dorë furçën e barin e dhëmbëve, komandanti filloi të thërras e të qajë.

-I gjori unë! Si e pësova kështu?... Ndihmomëni, vëllezër! Nuk dua të vdes! Jo nuk dua!

-Mirëpo bari i dhëmbëve e mbuloi të tërin dhe i mori frymën, gjersa e ngordhi....Pastaj furça fshiu nga faqet e dhëmbit ato qindra e mijëra mikrobe të ngordhura.

-Dhëmbët e bardhë si bora qeshën plot gaz për fitoren e vogëlushes Edlira mbi mikrobet e këqija.

*Flamur Topi*

## Fjalë dhe shprehje

- |                              |  |
|------------------------------|--|
| hijerëndë                    | • ka pamje të rëndë, mbahet me të madh             |
| të pikëlluar                 | • të mërzitur shumë                                |
| skuadra e higjienës sanitare | • skuadra e ruajtjes dhe e shërbimit të pastërtisë |
| ulërimë e përvajshme         | • e qarë me britma                                 |
| kasnec                       | • lajmëtar   |

## Bisedim

- Ç'shqetësim kishin mikrobet?
- Ç'detyrë morën zbuluesit?
- Përse mikrobet morën lajme të këqija?
- Ku shpresuan mikrobet se do të fitonin te Edlira?
- Cili i sulmoi ato në fund?

## Të lexojmë bukur

- Veçoni dhe lexoni fjalët e komandantit të mikrobeve.
- Lexojeni shqetësimin e komandantit në dhëmbët e Edlirës.
- Ndajeni pjesën sipas roleve dhe lexojeni.

## Ta ritregojmë përmbajtjen

Dy armiq të papajtueshëm. Skuadra e higjienës dhe ushtria e mikrobeve  
Përgatitja për luftë  
Armiqtë e Edlirës  
Fitorja e plotë mbi mikrobet

## Detyrë

Shkruani në fletore pjesën se ç'bëri Edlira para se të hante.

## Bisedë motivuese

Vizitoni qytetin më të afërt. Shikoni ndërtesat e mëdha, bisedoni për avionët, trenat, fabrikat etj.

### NJERIU

Është më i lartë  
se rroqaqielli-  
rrokaqiej ndërton.

Është i më i madh  
se mali, bjeshka-  
bjeshkën nënshton.

Është më i fortë  
se guri, shkëmbi-  
shkëmbin e bënë thërrmijë.

Është më i shpejtë  
se vetëtima-  
me mendjen e tij.

Është më i bardhë  
se drita e neonit-  
që ditën ëndërron.

Është më i lumtur  
se zogu i malit-  
kur i lirë gjallëron.

*Liri Loshi*



## Fjalë dhe shprehje

rrokaqiell	• ndërtesë e lartë, me shumë kate
bjeshka	• mali i madh

## Bisedim

Në këtë poezi është ngritur lart fuqia dhe mendja e njeriut. Njeriu del mbizotërues i natyrës dhe krijues i lumturisë së vet. Me çka e fiton ai këtë ?

## Përgjigju këtyre pyetjeve

- Pse njeriu është më i lartë se rrokaqielli?
- Pse njeriu është më i madh se bjeshka?
- Pse njeriu është më i fortë se guri?
- Pse njeriu është më i fortë se vetëtima?
- Kur është njeriu vërtet i lumtur?

## Detyrë

Shkruaj disa fjali për fuqinë e njeriut me këto fjalë: njeriu, lumi, uji, diga, drita.

## Bisedë motivuese

Për liri u bënë shumë flijime përgjatë shekujve. Bisedoni edhe për familjen e Adem Jasharit se si u vetëflijua ajo!

## PRINCESHA ARGJIRO

Dhe sytë e princeshës panë  
Si të fundit roje ranë.  
Ajo mbeti krejt e vetme,  
Yll në errësi të netve.

Atëherë turqit përpjetë  
U vërsulën që të tërë.  
Kështu në mbrëmje hedh deti,  
Dallgët e zeza në rërë.

Duan ta zënë të gjallë  
Po a ziret ylli, vallë?

Princësja me djep në krahë  
U vërtit nga kulla poshtë...  
Dallëndyshet i ke parë  
Kur mësojnë vjeshtës zogjtë?

Rrugën e parë në jetë  
Me foshnjën bënte princësja.  
Në qiell t'atdheut përpjetë  
Ajo mbeti, e varur peshë.

*Ismail Kadare*



### Bisedim

- Për ç'kohë flitet në këtë poezi?
- Çdo të ndodhte po të binte ajo në duar të sulmuesve?

### Detyrë

Ktheje këtë poezi në tregim të shkurtër.

# PËRMBAJTJA

## PËR TË GJITHË FËMIJËT E BOTËS

1. PUSHIMET VERORE MBARUAN - fq. 3
2. RRUGA E JETËS - fq. 4
3. ËNDRRA E DËRRASËS SË ZEZË - fq. 8
4. SA E GËZUAR JAM! - fq. 10
5. LIBRAT RRINË RADHË- RADHË - fq. 12
6. DETYRAT E SHTËPISË - fq. 14
7. STINËT - fq. 16
8. LIBRI, RADIOJA DHE TELEVIZORI - fq. 18
9. ÇANTA E ALBIONËS - fq. 20
10. DASHURIA PËR VENDIN - fq. 22
11. ZËRAT E NATYRËS - fq. 24
12. ARKA E FJALËVE - fq. 26
13. ZHAKU DHE MËSUESI - fq. 24
14. TEKSTI DHE FJALIA - fq. 28
15. FJALËT - fq. 29
16. EMRAT KONKRETË DHE EMRAT ABSTRAKTË - fq. 31
17. DY PISHA-fq. 32
18. MIRË SE ERDHE NË SHKUP, SKËNDERBE! - fq. 33
19. FJALIA DHE PJESËT E SAJ - fq. 34
20. RREZIKU NGA ABETARJA E PARË - fq. 35
21. UNË JAM SHQIPTAR - fq. 37
22. GJUHA JONË - fq. 38
23. DIALEKTET DHE GJUHA STANDARDE - fq. 39
24. KUJTOJ MËSUESIN - fq. 40
25. TOKA IME, KËNGA IME! - fq. 42 26 GJINIA E EMRIT - fq. 43
27. NËNA JONE TEREZE - fq. 44
28. NJË NDODHI NË RRUGË - fq. 45
29. DREJTSHKRIM I FJALËVE - fq. 47
30. LETRA E GENTIT - fq. 48
31. TA DUAM E TA NDEROJMË - fq. 50
32. MALLI PËR BABAIN - fq. 51
33. PËRRALLA NDJELLAKEQE - fq. 52
34. LETËR NGA LARG - fq. 54
35. MBIEMRI - fq. 55
36. NINULLA E MULLIRIT - fq. 56



37. ORA E MATEMATIKËS - fq. 57
38. BINJAKËT - fq. 58
39. QENË PESË GOCA - fq. 59
40. ÇAMARROKËT - fq. 60
41. MOS E FSHIH FAJIN - fq. 61
42. Ç' DO TË BEHEM - fq. 62
43. NËNA MILINGONË DHE BRUMBULLII ZI - fq. 63
44. PËRTACI - fq. 65
45. ZOGU I VOGËL ME PENDË TË HIRTA - fq. 66
46. PËRRALLA E PAMBARUAR - fq. 69
47. PËREMRI VETOR - fq. 70
48. PËRRALLA E GJYSHES - fq. 71
49. URIME NËNËS - fq. 72
50. SHKRIME JOLETRARE - fq. 73
51. MËMA-fq. 74
52. SUPË ME BARISHTE - fq. 75
53. JETA E NJË PIKE UJI - fq. 76
54. HËNA DHE XIXËLLONJA - fq. 77
55. STUHIA -fq. 78
56. RENDI I FJALËVE NË FJALI - fq. 79
57. ZAKONET E ÇUDITSHME TË QYQES - fq. 80
58. FOLJET NDIHMËSE KAM DHE JAM - fq. 81
59. GËZIMII BARDHIT - fq. 83
60. SINONIMET DHE ANTONIMET - fq. 84
61. TEUTA NË TEATËR - fq. 85
62. GËZUAR - fq. 86
63. LEJLEKU - fq. 87
64. KORÇA - fq. 88
65. BALADA E BURRAVE - fq. 89
66. I ATI, BIRI DHE GOMARI - fq. 90
67. E BIJA E HËNES DHE E DIELLIT - fq. 91
68. FËMIJA I MREKULLUESHËM I SHEKULLIT - fq. 94
69. LEGJENDA PËR TRE VËLLEZËRIT - fq. 96
70. GJARPRI, KUTIA DHE SYLIGU - fq. 98
71. FJALË TË URTTA DHE GJËEGJËZA POPULLORE - fq. 100
72. DIMRI - fq. 102
73. MBRETI KËRKON MENÇURI - fq. 104
74. FITORJA E EDLIRËS - fq. 106
75. NJERIU - fq. 109
76. PRINCESHA ARGJIRO - fq. 111

Dr. Avzi Mustafa - Xhevrije Mustafa

## **GJUHË SHQIPE**

për klasën IV  
të arsimit fillor nëntëvjeçar

### **Lektor**

Mr. Zeqirja Ibrahim

### **Përpunimi kompjuterik**

**dhe disejni**

Majlinda Mustafa

### **Përgatitja për shtyp - redaktimi**

PROSVETNO DELLO ShA

Rr. Dimitrija Çupovski 15 - Shkup

### **Shtypur në shtypshkronjën**

GRAFIÇKI CENTAR - Shkup

ЦИП – Каталогизација во публикација Народна и универзитетска библиотека „Климент Охридски,“ – Скопје

373.3016:811.18(075.2)

Мустафа, Авзи

Gjuhë shqipe për klasën IV: të arsimit fillor nëntëvjeçar / Авзи  
Мустафа, Цеврије Мустафа – Скопје: Министерство за образование и  
наука на Република Македонија, 2009, 113 стр. илустр. во боја; 29 см

ISBN - 978-608-4575-36-6

1. Мустафа, Цеврије (автор)

COBISS. MK-ID 79212810